



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 93

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 3 qershor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 40/2024, datë 2.5.2024	Për ofruesin e shërbimeve të lundrimit ajror “ <i>Albcontrol</i> ” 10367
Dekret i Presidentit nr. 196, datë 28.5.2024	Për shpallje ligji..... 10373
Ligj nr. 44/2024, datë 9.5.2024	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për financimin e projektit “Transporti i gjelbër i Tiranës”..... 10373
Dekret i Presidentit nr. 195, datë 27.5.2024	Për shpallje ligji..... 10387
Udhëzim i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 10, datë 25.5.2024	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 8, datë 3.5.2024, “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”..... 10387
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 16.5.2024	Iliria sh.p.k. kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 32850/16</i>) 10389
Urdhër i Komisionerëve Publikë nr. 51, datë 29.5.2024	Për shfuqizimin e kompetencave të deleguara..... 10397
Urdhër i Komisionerëve Publikë nr. 52, datë 29.5.2024	Për delegim kompetencash..... 10397
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat nr. 973, datë 27.12.2023	Për heqjen e plotë të zotësisë juridike për të vepruar të shtetasit Mehmet Petritaj..... 10398



LIGJ
Nr. 40/2024

**PËR OFRUESIN E SHËRBIMEVE TË
LUNDRIMIT AJROR “ALBCONTROL”**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj ka si objekt përcaktimin e formës së organizimit, të rregullave të funksionimit dhe të administrimit të ofruesit të shërbimeve të lundrimit ajror “*Albcontrol*”.

Neni 2
Fusha e veprimit

Ky ligj zbatohet për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror nga *Albcontrol*-i, duke përfshirë menaxhimin e trafikut ajror, shërbimet e komunikimit, të lundrimit dhe mbikëqyrjes, shërbimet e informacionit aeronautik, shërbimet meteorologjike për lundrimin ajror dhe shërbimet e hartimit të procedurave të fluturimit në të gjithë hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptohen:

1. “Aerodrom” është një zonë e përcaktuar mbi tokë ose mbi ujë, mbi një strukturë fikse, në det të hapur, e palëvizshme ose lundruese, duke përfshirë çdo ndërtesë, instalim dhe pajisje në të, të destinuara për t'u përdorur tërësisht ose pjesërisht për

mbërritjen, nisjen dhe lëvizjen në sipërfaqe të avionëve.

2. “*Albcontrol*” është enti publik i krijuar me këtë ligj, i cili vepron në interes publik dhe ofron shërbime të lundrimit ajror në Republikën e Shqipërisë.

3. “ICAO” është Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil në të cilën Republika e Shqipërisë aderon që nga viti 1990.

4. “Ent publik” është subjekti i së drejtës publike sipas përcaktimit në ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës dhe enteve publike”.

5. “*Eurocontrol*” është organizata civile-ushtarake panevropiane, e dedikuar për të mbështetur aviacionin evropian, në të cilën Republika e Shqipërisë aderon që nga viti 2001.

6. “Imunitet nga ekzekutimi” është pacenueshmëria e të ardhurave të *Albcontrol*-it të përfituara sipas shkronjës “b” të pikës 4 të nenit 16 të këtij ligji nga urdhrat e ekzekutimit.

7. “Kontrollor i trafikut ajror” është personi përgjegjës për sigurinë dhe efikasitetin e lëvizjes së avionëve në hapësirën ajrore të kontrolluar dhe në aerodrome.

8. “Kosto bazë” është kostoja e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror për zonat e pagesës nën përgjegjësinë e *Albcontrol*-it.

9. “Kosto për njësi” është kostoja e përllogaritur, duke pjesëtuar koston bazë të parashikuar të mbetur pas llogaritjes së fluturimeve të përjashtuara nga pagesat, me numrin e njërive të shërbimit të pagueshme të parashikuara për vitin përkatës.

10. “Marrëveshje ndërkombëtare” është çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

11. “Marrëveshje shumëpalëshe e ZPEA-së” është marrëveshja shumëpalëshe, shtojcat dhe protokollit i saj për krijimin e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ZPEA), e ratifikuar me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe misionit administrativ të përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, “Për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit



evropian”, në vijim referuar si marrëveshja shumëpalëshe.

12. “Ministri” është ministri përgjegjës për çështjet e transportit ajror.

13. “Publikimi i informacionit aeronautik (AIP)” është publikimi që përmban informacion aeronautik të një natyre afatgjatë, thelbësor për lundrimin ajror, i nxjerrë në përputhje me rregulloren e miratuar nga ministri.

14. “Sistemi i tarifave në rrugëkalim të *Eurocontrol-it*” është sistemi i vendosur në konventën e *Eurocontrol-it* “Për bashkëpunimin për sigurinë e lundrimit ajror” të 13 dhjetorit 1960, e ndryshuar, dhe në marrëveshjen shumëpalëshe “Për tarifën në rrugë” të 12 shkurtit 1981.

15. “Statuti” është akti që parashikon rregullat e funksionimit të brendshëm të *Albcontrol-it*, sipas dispozitave të këtij ligji.

16. “Shërbim publik” është tërësia e shërbimeve të lundrimit ajror të ofruara nga *Albcontrol-i* në interes publik.

17. “Tarifa e shërbimeve të lundrimit ajror në rrugëkalim (*en-route*)” është tarifa për një fluturim specifik në një zonë specifike tarifimi në rrugëkalim (*en-route*), e barabartë me prodhimin e kostos për njësi të vendosur për këtë zonë rrugëkalimi me njësitë e shërbimit të lundrimit ajror për këtë fluturim.

18. “Tarifa e shërbimeve të lundrimit ajror në aerodrome për nisjen dhe mbërritjen e fluturimeve” është tarifa e barabartë me prodhimin e kostos për njësi të vendosur për shërbimet e lundrimit ajror në aerodrome me njësitë e shërbimit të lundrimit ajror në aerodrome për këtë fluturim.

19. “Veprimtari jofitimprurëse” është veprimtaria e ushtruar nga enti publik, me qëllim ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror për përdoruesit e hapësirës ajrore në Republikën e Shqipërisë, duke u bazuar në parimin e rikuperimit të plotë të kostos.

KREU II

FORMA E ORGANIZIMIT DHE USHTRIMI I VEPRIMTARISË

Neni 4

Statusi juridik

1. *Albcontrol-i* është ent publik, jobuxhetor, veprimtaria e të cilit përbën shërbim publik dhe

kryhet nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për çështjet e transportit ajror.

2. *Albcontrol-i* gëzon pavarësi drejtuese, administrative, teknike dhe financiare.

Neni 5

Shërbimet e ofruara

1. *Albcontrol-i* ofron këto shërbime të lundrimit ajror:

a) menaxhimin e trafikut ajror (shërbimet e trafikut ajror, menaxhimin e hapësirës ajrore dhe menaxhimin e fluksit të trafikut ajror);

b) shërbimet e komunikimit, të lundrimit dhe mbikëqyrjes;

c) shërbimet e informacionit aeronautik;

ç) shërbimet meteorologjike për lundrimin ajror;

d) shërbimet e hartimit të procedurave të fluturimit.

2. *Albcontrol-i* ofron edhe shërbime të tjera në përputhje me Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë dhe me parimet e standardet ndërkombëtare të parashikuara në akte ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

3. *Albcontrol-i* ofron shërbime të lundrimit ajror edhe përtej territorit të Republikës së Shqipërisë, nëse kjo rrjedh nga një marrëveshje ndërkombëtare në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 6

Parimet e përgjithshme

Në përmbushjen e funksioneve dhe të kompetencave të parashikuara në këtë ligj, *Albcontrol-i* udhëhiqet nga këto parime:

a) ushtrimi i veprimtarisë në përputhje me konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e aviacionit civil, marrëveshjen shumëpalëshe të ZPEA-së, dispozitat e Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë, standardet ndërkombëtare të ICAO-s, rregulloret e zbatueshme të Komisionit Evropian të përafuara në legjislacionin kombëtar, marrëveshjet me *Eurocontrol-in*, dispozitat e këtij ligji, statutin dhe rregulloren e brendshme;

b) ofrimi i shërbimeve të lundrimit ajror për Republikën e Shqipërisë, duke pasur përparësi garantimin e sigurisë në operim, efikasitetin dhe rrjedhshmërinë e trafikut ajror;

c) garantimi i vazhdueshmërisë së shërbimeve të ofruara;



ç) zbatimi i politikave të shtetit shqiptar për zhvillimin dhe modernizimin e transportit ajror;

d) kryerja e veprimtarisë jofitimprurëse për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror sipas parimit të rikuperimit të plotë të kostos, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare.

Neni 7

Kompetencat e *Albcontrol*-it

1. Kompetencat e *Albcontrol*-it në ushtrimin e veprimtarisë së tij janë:

a) ofrimi i shërbimeve të lundrimit ajror, të nevojshme për të garantuar sigurinë në operim, efikasitetin dhe rrjedhshmërinë e trafikut ajror në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe aerodromet civile, të publikuara në AIP Albania;

b) menaxhimi efektiv i hapësirës ajrore dhe fluksit të trafikut ajror, si dhe përdorimi i sigurt dhe efikas i hapësirës ajrore nga të gjithë përdoruesit e saj nëpërmjet aplikimit të konceptit të përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore;

c) koordinimi i veprimeve me strukturat ushtarake për realizimin e misionit të patrullimit të hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë;

ç) në rast emergjencash, lëshimi i lejeve për hyrjen apo daljen përtej kufijve të miratuar dhe pranimi i ndryshimeve të rrugës së fluturimit të një avioni;

d) kryerja e investimeve për instalimin, mirëmbajtjen dhe rinovimin e sistemeve të operimit, teknologjisë dhe burimeve të energjisë;

dh) trajnimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm i personelit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rregulloret për trajnimin dhe licencimin e personelit;

e) integrimi dhe harmonizimi i plotë i sistemeve, teknologjisë dhe informacionit në kuadrin e një qielli të vetëm evropian;

ë) zbatimi i standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit;

f) llogaritja e kostos për njësi për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror në rrugëkalim (*en-route*), si dhe e kostos për njësi për shërbimet e ofruara në aerodrome dhe grupe aerodromesh;

g) administrimi i të ardhurave nga tarifatat për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror në rrugëkalim (*en-route*), të mbledhura nëpërmjet *Eurocontrol*-it;

gj) mbledhja e tarifave për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror në aerodrome nga *Albcontrol*-i ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij.

2. *Albcontrol*-i bashkëpunon, bashkërendon dhe harmonizon veprimtarinë me institucionet/entet publike dhe organizmat e tjerë kombëtarë, si dhe strukturat ndërkombëtare në fushën e aviacionit civil.

Neni 8

Ministri

1. Ministri është autoriteti më i lartë në fushën e aviacionit civil.

2. Në zbatim të politikave dhe përparësive në fushën e aviacionit civil, ministri nënshkruan marrëveshje shërbimi me *Albcontrol*-in ose i delegon detyra.

3. *Albcontrol*-i, në ushtrimin e veprimtarisë, zbaton politikat e shtetit shqiptar në fushën e aviacionit civil dhe raporton te ministri të paktën një herë në vit.

KREU III

ORGANET DREJTUESE DHE ORGANIZIMI

Neni 9

Organet drejtuese

Organet drejtuese të *Albcontrol*-it janë:

- Këshilli Drejtues;
- drejtori i përgjithshëm.

Neni 10

Këshilli Drejtues

1. Këshilli Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i *Albcontrol*-it dhe përbëhet nga 5 anëtarë.

2. Anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen nga ministri sipas një procedure përzgjedhjeje të bazuar në parimin e transparencës e të meritokracisë.

3. Anëtari i Këshillit Drejtues duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- të jetë shtetas shqiptar;
- të zotërojë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në shkenca juridike, ekonomike ose inxhinierike ose të



përzgjidhet si personalitet i njohur në fushën e tij profesionale;

c) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ç) të ketë eksperiencë profesionale jo më pak se 5 vjet në profesion në fushën e aviacionit civil ose në pozicione të ngjashme drejtuese apo administrimi;

d) ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) të mos ketë konflikt interesash me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi;

e) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

ë) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

4. Mandati i anëtarit të Këshillit Drejtues është 4 vjet, me të drejtë riemërimi 1 (një) herë.

5. Mandati i anëtarit të Këshillit Drejtues përfundon përpara afatit në rastet e mëposhtme kur:

a) jep dorëheqjen;

b) bëhet fizikisht i paafte për më shumë se 3 muaj të njëpasnjëshëm për të përmbushur detyrën për të cilën është emëruar;

c) mungon pa arsye në më shumë se tri mbledhje radhazi;

ç) vepron gjatë ushtrimit të funksioneve në kundërshtim me interesat e *Albcontrol-it*;

d) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

dh) humbet apo lë shtetësinë shqiptare;

e) plotëson kushtet për pension pleqërie;

ë) deklarohet i paafte për punë nga komisioni kompetent mjekësor;

f) gjendet në një situatë konflikti të vazhdueshëm interesi.

6. Këshilli Drejtues kryesohet nga kryetari, i cili zgjidhet nga Këshilli Drejtues në mbledhjen e parë të tij.

7. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues shpërblehen sipas përcaktimeve në statutin e *Albcontrol-it*.

8. Rregullat për shpalljen dhe procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Drejtues të *Albcontrol-it* përcaktohen me urdhër ministri.

Neni 11

Kompetencat e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues ka këto kompetenca kryesore:

a) miraton drejtimet kryesore të veprimtarisë së *Albcontrol-it*;

b) miraton statutin e *Albcontrol-it* dhe rregulloren e brendshme;

c) mbikëqyr administrimin dhe veprimtarinë e *Albcontrol-it*;

ç) miraton numrin e punonjësve të *Albcontrol-it* dhe nivelin e pagave e të shpërblimeve;

d) miraton programin ekonomik vjetor dhe e paraqet për aprovim te ministri;

dh) propozon te ministri kandidaturën për drejtor të përgjithshëm të *Albcontrol-it*;

e) miraton marrjen e kredive dhe huave për nevoja të ushtrimit të detyrave dhe aktivitetit të *Albcontrol-it*;

ë) emëron dhe shkarkon audituesit ligjorë;

f) miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportin e audituesve ligjorë;

g) përzgjedh audituesit e brendshëm dhe miraton programin vjetor të auditimit;

gj) merr vendime për çështje të nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të *Albcontrol-it*.

2. Këshilli drejtues ka edhe një sekretar, i cili zgjidhet ndërmjet punonjësve të administratës së *Albcontrol-it*.

3. Mënyra dhe procedurat e hollësishme të ushtrimit të detyrave të Këshillit Drejtues dhe zhvillimit të mbledhjeve përcaktohen në statutin e *Albcontrol-it*.

Neni 12

Drejtori i përgjithshëm

1. Drejtori i përgjithshëm është autoriteti më i lartë ekzekutiv dhe përfaqësuesi i *Albcontrol-it*.

2. Drejtori i përgjithshëm emërohet nga ministri sipas një procedure përzgjedhjeje të bazuar në parimin e transparencës e të meritokracisë.

3. Drejtor i përgjithshëm emërohet personi që përmbush kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

c) të zotërojë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfituar



në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në shkencë shoqërore, inxhinieri ose aviacion;

ç) të zotërojë kualifikime pasuniversitare të profilit;

d) të ketë përvojë pune mbi 7 vjet në pozicione administrimi, menaxhimi apo në fushën e aviacionit;

dh) të mos ketë interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë financiar ose interesa të tjera në struktura apo shoqëri tregtare të angazhuara në sektorin e aviacionit civil;

e) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

ë) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

f) ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi.

4. Mandati i drejtorit të përgjithshëm është 4 vjet, me të drejtë riemërimi.

5. Mandati i drejtorit të përgjithshëm përfundon para afatit në rastet e mëposhtme kur:

a) jep dorëheqjen;

b) bëhet fizikisht i paaftë për më shumë se 3 muaj të njëpasnjëshëm për të përmbushur detyrën për të cilën është emëruar;

c) për shkak të paaftësisë profesionale apo neglizhencës i shkakton dëm *Albcontrol*-it ose imazhit të institucionit;

ç) vepron gjatë ushtrimit të funksioneve në kundërshtim me interesat e *Albcontrol*-it;

d) dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për një vepër penale;

dh) humbet apo lë shtetësinë shqiptare;

e) plotëson kushtet për pension pleqërie;

ë) nuk përmbush detyrat e caktuara sipas nenit 13 të këtij ligji;

f) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;

g) gjendet në një situatë konflikti të vazhdueshëm interesi.

6. Rregullat për shpalljen dhe procedurën e përzgjedhjes së drejtorit të përgjithshëm të *Albcontrol*-it përcaktohen me urdhër ministri.

Neni 13

Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm

Drejtori i përgjithshëm ka kompetencat e mëposhtme:

a) siguron ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi të *Albcontrol*-it në pajtim me legjislacionin në fuqi;

b) ndjek të gjitha çështjet e sigurisë, teknike, operacionale, administrative, financiare dhe ligjore, të lidhura drejtpërsëdrejti apo tërthorazi me veprimtarinë e *Albcontrol*-it;

c) drejton veprimtarinë administrative dhe organizative të *Albcontrol*-it dhe ndjek zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues;

ç) përfaqëson *Albcontrol*-in në marrëdhënie me të tretët, si dhe në projektet e iniciativat kombëtare e ndërkombëtare të ndërlidhura me aktivitetet e tij;

d) administron buxhetin dhe burimet financiare të *Albcontrol*-it;

dh) miraton strukturën organizative të *Albcontrol*-it në bazë të nevojave teknike, operacionale dhe administrative;

e) emëron dhe shkarkon punonjësit e *Albcontrol*-it;

ë) kërkon thirrjen e mbledhjeve të Këshillit Drejtues, kur e konsideron të nevojshme;

f) kryen të gjitha detyrat e tjera që i ngarkon ky ligj, statuti dhe rregullorja e brendshme e *Albcontrol*-it.

Neni 14

Marrëdhëniet e punës dhe personeli

1. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e *Albcontrol*-it rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës, këtij ligji dhe akteve nënligjore në fushën e lundrimit ajror.

2. Punonjësit e *Albcontrol*-it, që ushtrojnë funksione specifike dhe që kanë akses në zonat me siguri të kufizuar, i nënshtrohen kontrollit të së kaluarës sipas përcaktimeve të Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë.

Neni 15

Konflikti i interesit

Gjatë veprimtarisë së tyre, anëtarët e Këshillit Drejtues, drejtori i përgjithshëm dhe punonjësit e *Albcontrol*-it parandalojnë dhe shmangin konfliktin e interesit, sipas legjislacionit në fuqi.



KREU IV FINANCIMI, TARIFAT, KOSTOJA PËR NJËSI DHE KONTABILITETI

Neni 16

Burimet e financimit

1. *Albcontrol*-i nuk është subjekt fitimprurës.
2. Burimet e financimit të *Albcontrol*-it janë:
 - a) fondet e përfituara nga tarifatat e ofrimit të shërbimeve të lundrimit ajror në rrugëkalim (*en-route*) dhe nga tarifatat e ofrimit të shërbimeve të lundrimit ajror në aerodrome, për nisjen dhe mbërritjen e fluturimeve;
 - b) fonde të buxhetit të shtetit në raste të jashtëzakonshme dhe kur veprimtaria e *Albcontrol*-it cenohet nga shkaqe të pavarura prej tij;
 - c) burime të tjera të lejuara nga legjislacioni në fuqi.
3. Burimet e financimit *Albcontrol*-i i përdor për kryerjen e veprimtarive të veta sipas këtij ligji dhe përcaktimeve në statut.
4. Fondet e përfituara nga tarifatat sipas shkronjës “a” të pikës 2 të këtij neni përdoren ekskluzivisht për mbulimin e kostos së ofrimit të shërbimeve të lundrimit ajror dhe mundësimin e veprimtarisë së *Albcontrol*-it, në funksion të këtyre shërbimeve, në përputhje me parimet dhe marrëveshjet ndërkombëtare dhe gëzojnë imunitet nga urdhrat e ekzekutimit deri në masën e nevojshme për ushtrimin e aktivitetit normal të *Albcontrol*-it.

Neni 17

Tarifatat për shërbimet e lundrimit ajror

1. Tarifatat për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror llogariten nga *Albcontrol*-i duke reflektuar koston bazë të shërbimeve dhe përballohen nga përdoruesit e këtyre shërbimeve.
2. Tarifatat e lundrimit ajror përfshijnë tarifatat e ofrimit të shërbimeve të lundrimit ajror në rrugëkalim (*en-route*) dhe tarifatat për shërbimet e lundrimit ajror, që ofrohen në aerodrome për nisjen dhe mbërritjen e fluturimeve.
3. Tarifatat e lundrimit ajror në rrugëkalim (*en-route*) përcaktohen, faturohen dhe mbledhen nga *Eurocontrol*-i në emër të Republikës së Shqipërisë, bazuar në sistemin e tarifave në rrugëkalim (*en-route*) të *Eurocontrol*-it dhe kalojnë në llogarinë bankare të *Albcontrol*-it. Këto tarifa faturohen si një tarifë e

vetme për fluturimin, në bazë të distancës së fluturuar brenda secilit vëllim tarifor të hapësirës ajrore dhe në bazë të peshës së avionit.

4. Tarifatat për shërbimet e lundrimit ajror, që ofrohen në aerodrome ose grupe aerodromesh për nisjen dhe mbërritjen e fluturimeve, llogariten si një tarifë vetëm për nisjen e fluturimit, duke marrë parasysh peshën e avionit dhe duke aplikuar metodat e përcaktuara dhe të miratuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil. Tarifatat e llogaritura sipas kësaj pike faturohen dhe mbledhen nga *Albcontrol*-i ose përfaqësuesi i autorizuar i tij.

5. Rastet e fluturimeve të përjashtuara nga këto tarifa përcaktohen në marrëveshjen me *Eurocontrol*-in dhe publikohen në AIP Albania.

Neni 18

Kostoja për njësi

1. Kostoja për njësi për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror në rrugëkalim (*en-route*) llogaritet nga *Albcontrol*-i si një njësi kostojë mbi bazë vjetore për çdo vëllim tarifor të hapësirës ajrore, në përputhje me parimet për përcaktimin e koston bazë. Kostot miratohen nga *Eurocontrol*-i.
2. Kostoja për njësi për shërbimet e lundrimit ajror të ofruara në aerodrome dhe grupe aerodromesh llogaritet nga *Albcontrol*-i si njësi kostojë me bazë vjetore në përputhje me dispozitat e Kodit Ajror.

Neni 19

Kontabiliteti dhe pasqyrat financiare

1. *Albcontrol*-i mban llogaritë dhe regjistrat në përputhje me legjislacionin në fuqi për raportimin financiar dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.
2. *Albcontrol*-i përgatit pasqyrat financiare vjetore brenda afateve të përcaktuara me ligj. Pasqyrat financiare janë subjekt certifikimi nga audituesit ligjorë sipas përcaktimeve të kuadrit rregullator në fushën e auditimit ligjor.
3. Pasqyrat financiare publikohen në faqen zyrtare të *Albcontrol*-it dhe paraqiten në *Eurocontrol*.



KREU V
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË
FUNDIT

Neni 20

Riemërtimi i certifikatave të operimit

1. *Albcontrol*-i, përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, i paraqet Autoritetit të Aviacionit Civil kërkesën për ndryshimin e emërimit në certifikatat e ofrimit të shërbimeve të lundrimit ajror.

2. Deri në momentin e lëshimit të certifikatave të riemërtuara, shërbimet e lundrimit ajror ofrohen nga shoqëria “ALBCONTROL” sh.a.

Neni 21

Prishja e shoqërisë “ALBCONTROL” sh.a.

1. Shoqëria “ALBCONTROL” sh.a., prishet pa kaluar në likuidim.

2. Të gjitha të drejtat, detyrimet dhe pasuritë e shoqërisë “ALBCONTROL”, sh.a., i transferohen *Albcontrol*-it.

3. Ngarkohet aksionari i shoqërisë “ALBCONTROL” sh.a., të caktojë auditues ligjor për ndjekjen e procedurave të nevojshme.

Neni 22

Aktet nënligjore

Ngarkohet ministri që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10, pika 8, dhe 12, pika 6, të këtij ligji.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.5.2024

Shpallur me dekretin nr. 196, datë 28.5.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 196, datë 28.5.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 40/2024, “Për ofruesin e shërbimeve të lundrimit ajror ‘*Albcontrol*’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ

Nr. 44/2024

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË (HUAMARRËSI),
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË, DHE
KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW) PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT
“TRANSPORTI I GJELBËR I TIRANËS”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për financimin e projektit “Transporti i gjelbër i Tiranës”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.



Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 9.5.2024.

Shpallur me dekretin nr. 195, datë 27.5.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJE HUAJE

datë 28 dhjetor 2023,
ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi),
e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe
Ekonomisë,
dhe KfW Frankfurt Am Main (KfW)
50,000,000.00 euro
– Transporti i gjelbër, Tiranë –
BMZ-nr. 2019 68 361
ID-ja e huas: 31222

PËRMBAJTJA

1. Huaja
2. Kanalizimi i kredisë në agjencinë e ekzekutimit të projekteve
3. Disbursimi
4. Tarifat
5. Interesi
6. Shlyerja dhe parapagimi
7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi
8. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë
9. Paligjshmëria
10. Kostot dhe tarifat publike
11. Detyrime të veçanta
12. Arsyet e zgjidhjes
13. Përfaqësimet dhe deklaratat
14. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me projektin
15. Dispozita të përgjithshme

PREAMBULË

Baza për këtë marrëveshje huaje ndërmjet KfW-së dhe huamarrësit (“Marrëveshja” ose “Marrëveshja e huas”) është marrëveshja e datës 29 prill 2021, e lidhur ndërmjet qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe qeverisë së Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin financiar (BF) (marrëveshja qeveritare).

KfW-ja do ta rifinancojë huan e dhënë në pajtim me kushtet e kësaj marrëveshjeje, me subvencione interesi nga fonde buxheti me interes të ulët, të dhëna nga Republika Federale e Gjermanisë për projekte që i përmbushin kriteret e pranimit të politikave të zhvillimit. Termat dhe kushtet e huas janë në përputhje me kërkesat e OECD-së, të zbatueshme në datën e nënshkrimit të marrëveshjes për njohje si Asistencë Zyrtare për Zhvillim (ODA).

Për të plotësuar fondet e dhëna më poshtë, Komisioni Evropian ka vënë në dispozicion fonde shtesë sipas Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor (“WBIF”) nëpërmjet KfW-së. Si rrjedhojë, KfW-ja dhe huamarrësi synojnë të lidhin një marrëveshje të veçantë granti, në një shumë deri në 31,200,000.00 euro, për financimin e pjesshëm të projektit (siç përcaktohet më poshtë) (Marrëveshja e grantit WBIF).

Mbi këtë bazë dhe me kusht që Republika Federale e Gjermanisë të japë garanci për huan, KfW-ja do të japë një hua, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje huaje.

1. Huaja

1.1 *Shuma.* KfW-ja i ofron huamarrësit një hua e cila nuk e tejkalon shumën **50,000,000.00 euro (huaja)** (në fjalë: **pesëdhjetë milionë euro**).

1.2 *Qëllimi.* Huamarrësi në këtë drejtim, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ia kanalizon kredinë në tërësi Bashkisë së Tiranës, duke vepruar si agjenci për ekzekutimin e projekteve (agjencia e ekzekutimit të projekteve), në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Huamarrësi siguron që agjencia e ekzekutimit të projekteve të përdorë kredinë ekskluzivisht për futjen e një sistemi të tranzitit të shpejtë të autobusëve bazuar në autobusët elektrikë me bateri në Tiranë (projekti). Detajet e projektit, si dhe furnizimet e shërbimet që do të financohen nga huaja do të përcaktohen me marrëveshje të veçantë, të lidhur ndërmjet agjencisë së zbatimit të projektit dhe KfW-së (**marrëveshja e veçantë**), dhe gjithashtu do të nënshkruhet siç lexohet dhe dakordësohet nga huamarrësi përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

1.3 *Taksat, tarifat dhe detyrimet doganore.* Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të shlyhen nga huamarrësi ose agjencia e ekzekutimit të projekteve, si dhe tatimet doganore nuk do të financohen nga huaja.



2. Kalimi i kredisë në agjencinë e ekzekutimit të projekteve

2.1 *Marrëveshja e kalimit.* Huamarrësi e kalon kredinë pranë agjencisë së ekzekutimit të projekteve sipas një marrëveshjeje të veçantë nënkredie, sipas kushteve të përcaktuara në nenet 5.1 dhe 6.1.

2.2 *Përkthim i certifikuar.* Përpara lëvrimit të parë nga kredia, huamarrësi i dërgon KfW-së një përkthim të certifikuar të marrëveshjes së nënkredisë, të përmendur në nenin 2.1.

2.3 *Asnjë përgjegjësi e agjencisë së ekzekutimit të projekteve.* Kalimi i kredisë nuk përbën asnjë përgjegjësi të agjencisë së ekzekutimit të projekteve ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj marrëveshjeje kredie.

3. Disbursimi

3.1 *Kërkesat për disbursim.* Sapo të përmbushen të gjitha kushtet paraprake për disbursimin sipas nenit 3.3 (*kushtet paraprake të disbursimit*), KfW-ja do ta disbursojë huan në pajtim me progresin e projektit dhe me kërkesën e agjencisë së ekzekutimit të projekteve, kërkesë e cila është e pakthyeshme. Disbursimet do të bëhen në përputhje me grafikun e disbursimit të parashikuar në shtojcën 1 (*grafiku i disbursimit*) të kësaj marrëveshjeje huaje. KfW-ja do të kryejë disbursime vetëm deri në shumat maksimale të përcaktuara për çdo periudhë disbursimi të specifikuar në shtojcën 1. Në masën që huamarrësi kërkon disbursime për shumën më të vogël brenda çdo periudhe të tillë, shumat e padisburuara mund të kërkojnë në çdo periudhë pasuese. Me përjashtim të disbursimit të fundit, KfW-ja nuk është e detyruar të kryejë disbursime në një shumë më të vogël se 200.000,00 euro.

3.2 *Afati për kërkimin e disbursimeve.* KfW-ja gëzon të drejtën t'i refuzojë disbursimet pas datës **30 dhjetor 2029**.

3.3 *Kushtet paraprake të disbursimit.* KfW-ja është e detyruar të kryejë disbursime sipas kësaj marrëveshjeje, vetëm me përmbushjen e kushteve të mëposhtme paraprake nga pala përkatëse ose personi i tretë, siç mund të jetë rasti në formë dhe përmbajtje të pranueshme për KfW-në:

a) huamarrësi duhet t'i tregojë KfW-së, duke i paraqitur konfirmimin ligjor dhe kopje të certifikuara (secila prej tyre duhet të ketë përkthimin zyrtar në gjuhën e kësaj marrëveshjeje) të të gjitha dokumenteve të cilave u referohet ky konfirmim ligjor, se marrëveshja e huas është plotësisht efektive

dhe e zbatueshme nga pikëpamja ligjore dhe duhet t'i vërtetojë në mënyrë të veçantë se:

i. huamarrësi i ka përmbushur të gjitha kërkesat e së drejtës kushtetuese dhe dispozitat e tjera ligjore të zbatueshme, që lidhen me detyrimet e tij në kuadër të kësaj marrëveshjeje; dhe se

ii. KfW-ja është përjashtuar nga të gjitha tatimet mbi të ardhurat nga interesat, detyrimet, komisionet dhe kostot e ngjashme në Republikën e Shqipërisë gjatë dhënies së huas;

b) KfW-ja zotëron origjinalin e kësaj marrëveshjeje dhe marrëveshjes së veçantë, ku secila është nënshkruar ligjërisht;

c) modelet e nënshkrimeve të përmendura në nenin 13.1 (*përfaqësimi i huamarrësit dhe agjencia e ekzekutimit të projekteve*) janë marrë nga KfW-ja;

d) garancia nga Republika Federale e Gjermanisë, e përmendur në nenin 8 (*garancia e Republikës Federale të Gjermanisë*) është në fuqi dhe efekt pa kufizim;

e) huamarrësi e ka paguar tarifën e menaxhimit të përcaktuar në nenin 4.2 (*tarifat e menaxhimit*);

f) huamarrësi ka dhënë një përkthim të certifikuar të marrëveshjes së nënkredisë, të përmendur në nenin 2.1;

g) nuk ka ndodhur asnjë arsye për zgjidhjen e marrëveshjes, as ndonjë incident që do të përbente shkak për zgjidhjen e marrëveshjes me anë të njoftimit paraprak ose përfundimit, ose konstatimit apo plotësimit të një kushti (arsye e mundshme për zgjidhjen e marrëveshjes); dhe

h) nuk kanë lindur rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit, ose përmbushjen e detyrimeve të pagesës të marra përsipër nga huamarrësi sipas kësaj marrëveshjeje.

Para disbursimit nga huaja, KfW-ja ka të drejtën të kërkojë dokumente dhe prova të tjera që i çmon të nevojshme, sipas diskrecionit të saj për të konstatuar kushtet paraprake për disbursimin, të përcaktuara në këtë seksion.

3.4 *Detaje të procedurës së disbursimit.* Agjencia e ekzekutimit të projekteve dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e procedurës së disbursimit me marrëveshje të veçantë dhe, në veçanti, provat që duhet të jepen nga agjencia e ekzekutimit të projekteve, që dokumentojnë se shumat e kërkuara të kredisë po përdoren për qëllimin e rënë dakord.

3.5 *E drejta për të anuluar disbursimet.* Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të tij, sipas nenit 11 (*detyrimet e veçanta*), Huamarrësi mund të heqë dorë



nga disbursimi i shumës së huas së padisbursuar me pëlqimin paraprak të KfW-së kundrejt pagesës së **kompensimit të mospërdorimit**, sipas dhe siç përkufizohet në nenin 3.6 (*kompensimi i mospërdorimit*) të kësaj marrëveshjeje.

3.6 *Kompensimi i mospërdorimit*. Nëse huamarrësi anulon disbursimin e një shume huaje për të cilën një normë interesi është përcaktuar tashmë sipas nenit 3.4 (*e drejta për anulimin e disbursimit*) ose nëse shuma e kësaj huaje nuk disbursohet, ose nuk disbursohet brenda afatit të përcaktuar në nenin 3.2 (*afati për kërkimin e disbursimeve*), huamarrësi do t'i paguajë menjëherë KfW-së, sipas kërkesës së saj, shumën që është e nevojshme për të kompensuar KfW-në për çdo humbje, shpenzim ose kosto të shkaktuar nga KfW-ja si rezultat i mosdisbursimit të shumës së huas (**kompensimi i mospërdorimit**), me përjashtim të rasteve kur mosdisbursimi përbën një shkelje të kësaj marrëveshjeje nga KfW-ja. KfW-ja e llogarit shumën e kompensimit të mospërdorimit dhe ia komunikon huamarrësit. Kompensimi i mospërdorimit duhet përdorur njëjloj sikur Republika Federale e Gjermanisë të mos ketë dhënë asnjë subvencion interesi për projektin.

4. Tarifat

4.1 *Tarifa e zotimit financiar*. Huamarrësi paguan një tarifë të parimbursueshme të zotimit financiar prej **0.25 %** në vit (**tarifa e zotimit financiar**) për shumën e padisbursuar të huas.

Tarifa e zotimit bëhet e kërkueshme për pagesë çdo gjysmëviti, në fund të periudhës 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti, ku për herë të parë bëhet e kërkueshme më [15 maj 2025], por jo më parë se në datën përkatëse pas datës në të cilën kjo marrëveshje hyn në fuqi, sipas nenit 15.11 (*hyrja në fuqi dhe në efekt*).

Tarifa e angazhimit do të faturohet nëse është me efekt prapaveprues, për periudhën që fillon dymbëdhjetë muaj pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje dhe do të zgjasë deri në datën e disbursimit të plotë të huas ose, nëse është e zbatueshme, deri në datën e përfundimit të plotë të disbursimeve nga huaja.

4.2 *Tarifa e menaxhimit*. Për menaxhimin, huamarrësi do t'i paguajë KfW-së një tarifë të parimbursueshme dhe të pakthyeshme të barabartë me **0.50 %** të shumës së huas së përcaktuar në nenin 1.1 (shuma) (**tarifa e menaxhimit**).

Tarifa e menaxhimit bëhet e pagueshme në datën më të hershme prej dy datave në vijim: i. para disbursimit të parë; ose ii. pas kalimit të gjashtë

muajve që prej nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje nga KfW-ja, ose me kalimin e një periudhe njëmuajore pasi kjo marrëveshje të ketë hyrë në fuqi dhe efekt (në varësi se cila nga datat e përcaktuara sipas pikës “ii” është më e vonshme). Tarifa e menaxhimit është e kërkueshme për pagesë me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, pavarësisht nëse huaja është disbursuar plotësisht ose vetëm pjesërisht, ose nëse nuk është disbursuar.

5. Interesi

5.1 *Norma fikse e interesit e përcaktuar për disbursimin e huas*

a) *Norma e interesit*. Huamarrësi paguan interes për çdo shumë huaje të disbursuar në normën (**norma fikse e interesit**) të përcaktuar nga KfW-ja, brenda dy **ditësh bankare** (siç përkufizohet në nenin 15.1 (*dita bankare*)), përpara disbursimit të shumës përkatëse të huas dhe ky interes përbëhet nga:

i. norma e shkëmbimit e përcaktuar në bazë të faqes *Reuters* “ICAPEURO” ose, nëse kjo faqe nuk përmban detajet e nevojshme apo nuk është e aksesueshme, në faqen e *Bloomberg* “ICAE” (ose në një faqe tjetër që zëvendëson faqen e *Bloomberg* dhe *Reuters* të cituar më lart). Nëse asnjëra prej këtyre faqeve nuk i përmban të dhënat e nevojshme ose janë të paaksesueshme, KfW-ja e përcakton këtë normë në bazë të kostove efektive të financimit në tregun e kapitalit në euro, për maturime që përkojnë sa më shumë të jetë e mundur me periudhat përkatëse të normave të interesit;

ii. plus një marzh prej 0.55 (zero presje pesëdhjetë e pesë) % në vit, që merr parasysh fondet e grantit të vëna në dispozicion nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë;

b) Nëse norma e interesit, e llogaritur në përputhje me sa më lart, bie nën 0% në vit, norma fikse e interesit do të jetë 0 % në vit;

c) Kështu, norma fikse e interesit të përcaktuar do të zbatohet deri kur të jetë marrë edhe kësti i fundit i pagesës, në përputhje me grafikun e pagesave të përcaktuar në nenin 6.1 (*grafiku i pagesave*);

b) *Konsolidimi*. Nëse nga huaja është bërë më shumë se një disbursim, KfW-ja e konsolidon normën fikse të interesit për çdo shumë huaje në një normë të vetme interesi pas çdo disbursimi.

Norma e konsoliduar fikse e interesit përkon me mesataren e ponderuar të normave individuale të interesit, të rumbullakosura në 1/10,000 të një pikë përqindjeje, nëse shifra e parë pas presjes është më e



ulët se 5 ose e rrumbullakosur në 1/10,000 të një pikë përqindjeje, nëse shifra e parë pas presjes është e barabartë ose më e madhe se 5 dhe kjo do të shërbejë si bazë për llogaritjet e ardhshme të normës së interesit nga data e çdo disbursimi deri në disbursimin tjetër. Pas disbursimit të plotë të huas, norma e përcaktuar mesatare fikse e interesit do të zbatohet deri kur të jetë marrë edhe kësti i fundit i pagesës, në përputhje me grafikun e pagesave të përcaktuar në nenin 5.1 (*grafiku i pagesave*);

c) *Njoftimi i normës së interesit*. KfW-ja e njofton huamarrësin, pa vonesë, për normën fikse të interesit sipas nenit 5.1/a (norma e interesit) menjëherë pasi kjo normë të jetë përcaktuar. KfW-ja e njofton huamarrësin për normën e konsoliduar të interesit sipas nenit 5.1/b (*konsolidim*) përpara datës së ardhshme të pagesës (siç përcaktohet në nenin 5.3 (*datat e pagesës*)).

5.2 *Llogaritja e interesit*. Interesi për një shumë të disbursuar të huas do të faturohet nga data (duke e përjashtuar) në të cilën shuma përkatëse e huas disbursohet nga llogaria e huas që mbahet te KfW-ja për huamarrësin deri në datën (duke e përfshirë) në të cilën shlyerjet përkatëse kreditohen në llogarinë e KfW-së, të përcaktuar këtu në nenin 7.3 (*numri i llogarisë, koha e kreditimit*). Interesi do të llogaritet në pajtim me nenin 7.1 (*llogaritja*).

5.3 *Datat e pagesës*. Interesi do të jetë i kërkueshëm në shuma të prapambetura për pagesë në datat e përcaktuara më poshtë (secila e referuar si “Datë pagese”):

a) para datës së kërkueshme të këstit të shlyerjes së parë, më 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti, por jo më parë se në datën e pagesës pas datës kur kjo marrëveshje hyn në fuqi dhe në efekt, në bazë të nenit 15.11 (*hyrja në fuqi dhe në efekt*);

b) në datën e kërkueshme të këstit të shlyerjes së parë në bazë të nenit 6.1 (*grafiku i shlyerjes*) së bashku me këtë këst;

c) më pas, në datat e kërkueshme të kësteve të shlyerjes në bazë të nenit 6.1 (*grafiku i shlyerjes*).

6. Shlyerja dhe parapagimi

6.1 *Grafiku i shlyerjes*. Huamarrësi do ta shlyejë huan, si më poshtë:

Kësti	Data e kërkueshme	Kësti i shlyerjes
1	15 nëntor 2028	2.380.952,38 €
2	15 maj 2029	2.380.952,38 €
3	15 nëntor 2029	2.380.952,38 €
4	15 maj 2030	2.380.952,38 €

5	15 nëntor 2030	2.380.952,38 €
6	15 maj 2031	2.380.952,38 €
7	15 nëntor 2031	2.380.952,38 €
8	15 maj 2032	2.380.952,38 €
9	15 nëntor 2032	2.380.952,38 €
10	15 maj 2033	2.380.952,38 €
11	15 nëntor 2033	2.380.952,38 €
12	15 maj 2034	2.380.952,38 €
13	15 nëntor 2034	2.380.952,38 €
14	15 maj 2035	2.380.952,38 €
15	15 nëntor 2035	2.380.952,38 €
16	15 maj 2036	2.380.952,38 €
17	15 nëntor 2036	2.380.952,38 €
18	15 maj 2037	2.380.952,38 €
19	15 nëntor 2037	2.380.952,38 €
20	15 maj 2038	2.380.952,38 €
21	15 nëntor 2038	2.380.952,40 €

Ky grafik pagese mund të përshtatet, herë pas here, në përputhje me nenin 6.5 (*grafiku i rishikuar i pagesave*).

6.2 *Shumat e padisbursuara të huas*. Shumat e padisbursuara të huas do të kompensohen kundrejt këstit përkatës të fundit të shlyerjes, në pajtim me grafikun e shlyerjes, të përcaktuar në nenin 6.1 (*grafiku i shlyerjes*), përveç kur KfW-ja, sipas diskrecionit të saj, zgjedh një alternativë tjetër kompensimi në raste të veçanta.

6.3 *Shlyerjet në rast të disbursimit të paplotë*. Nëse një këst shlyerjeje është i kërkueshëm para disbursimit të plotë të huas, kjo nuk do të cenojë grafikun e shlyerjes, në bazë të nenit 6.1 (*grafiku i shlyerjes*), për sa kohë që kësti i shlyerjes, i kërkueshëm në pajtim me grafikun e shlyerjes, është më i vogël sesa shuma e huas e disbursuar dhe ende e pashlyer (**shuma e papaguar e huas**). Nëse kësti i shlyerjes, i kërkueshëm në pajtim me nenin 6.1 (*grafiku i shlyerjes*), tejkalon shumën e papaguar të huas, ky këst shlyerjeje do të ulet në nivelin e shumës së papaguar të huas dhe diferenca do të shpërndahet në mënyrë të barabartë për këstet e shlyerjes ende të papaguara. Në llogaritjen e shumës së papaguar të huas, KfW-ja rezervon të drejtën për të shqyrtuar disbursimet nga huaja që kryhen brenda një periudhe prej 45 ditësh ose disa ditë para një date pagese për përcaktimin e shumës së papaguar të huas, vetëm për datën e ardhshme pasuese të pagesës.

6.4 *Parapagimi*. Për parapagimet gjejnë zbatim sa më poshtë:

a) *E drejta e parapagimit*. Huamarrësi, në pajtim me pikat e mëposhtme 6.4/b (*njoftimi*) deri te 6.4/e



(kompensimi), ka të drejtë të shlyejë shumën huaje para datës së kërkueshme të planifikuar, nëse ky parapagim është të paktën në shumën e një kësti shlyerjeje në pajtim me nenin 6.1 (grafiku i shlyerjes);

b) *Njoftimi*. Një parapagim i një shume huaje, në pajtim me nenin 6.4/a (e drejta për parapagim), i nënshtrohet një njoftimi parapagimi nga huamarrësi drejtuar KfW-së, jo më vonë se dita bankare e pesëmbëdhjetë para datës së synuar të parapagimit. Ky njoftim është i pakthyeshem dhe duhet të përcaktojë datën dhe shumën e parapagesës, si dhe e detyron huamarrësin t'i paguajë KfW-së shumën e përcaktuar në datën e përcaktuar;

c) *Tarifa e parapagimit*. Nëse huamarrësi parapaguan një shumë huaje me interes fiks, huamarrësi i paguan menjëherë KfW-së, me kërkesë të saj, shumën e nevojshme për të kompensuar çdo humbje, shpenzim ose kosto që i është shkaktuar KfW-së si rezultat i këtij parapagimi (tarifa e parapagimit). KfW-ja e përcakton shumën e tarifës së parapagimit dhe ia komunikon huamarrësit. Tarifa e parapagimit duhet përdorur njëjloj sikur Republika Federale e Gjermanisë të mos ketë dhënë asnjë subvencion interesi për projektin. Me kërkesë të huamarrësit, KfW-ja do t'i japë huamarrësit një të dhënë të shumës së tarifës së parapagimit para njoftimit të kërkuar të parevokueshem për shlyerjen, në bazë të nenit 6.4/b (njoftimi);

d) *Shumat e kërkueshme*. Së bashku me parapagimin, në pajtim me nenin 6.4/a (e drejta për parapagim), huamarrësi do të paguajë shumën e mëposhtme:

i. çdo tarifë parapagimi të kërkueshme si rezultat i parapagimit, sipas nenit 6.4/c (tarifa e parapagimit); dhe

ii. të gjithë interesin e mbledhur për shumën e huas së parapaguar dhe çdo pagesë tjetër që është ende e pashlyer në kuadër të kësaj marrëveshjeje, që është mbledhur deri në datën e parapagimit;

e) *Kompensimi*. Neni 6.2 (shumat e padisbursuara të huas) zbatohet *mutatis mutandis* për kompensimin e parapagimeve.

6.5 *Grafiku i rishikuar i pagesave*. Në rastin kur zbatohet neni 6.3 (shlyerjet në rast të disbursimit të paplotë) ose neni 6.4 (parapagim), KfW-ja do t'i dërgojë huamarrësit një grafik të rishikuar shlyerjeje që do të bëhet pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje dhe do të zëvendësojë grafikun e shlyerjes, të vlefshëm deri në atë kohë, të këtij zëvendësimi pas disbursimit të fundit sipas huas nga KfW-ja.

7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi

7.1 *Llogaritja*. Interesi, tarifa e zotimit financiar, kamatëvonesa sipas nenit 7.5 (kamatëvonesa), kompensimi si një këst i vetëm për shumën e vonuara sipas nenit 7.6 (kompensimi si këst i vetëm), kompensimi i mospërdorimit dhe tarifa e parapagimit llogariten në bazë të vitit kalendarik prej 360 ditësh me muaj me nga tridhjetë ditë.

7.2 *Data e kërkueshme*. Nëse një pagesë që duhet të kryhet në lidhje me këtë marrëveshje bëhet e kërkueshme në një datë që nuk është ditë bankare, huamarrësi duhet ta kryejë këtë pagesë në ditën bankare pasuese. Nëse data e ardhshme bankare bie brenda muajit të ardhshëm kalendarik, kjo pagesë bëhet në datën e fundit bankare të muajit kalendarik aktual.

7.3 *Numri i llogarisë, koha e kreditimit*. Huamarrësi do të lirohet nga detyrimet e tij të pagesës në lidhje me këtë marrëveshje, nëse dhe deri në masën që shumën përkatëse do t'i jenë kredituar KfW-së, në disponim të saj të lirë, pa asnjë zbritje në euro dhe jo më vonë se ora 10:00 paradite në *Frankfurt am Main*, Republika Federale e Gjermanisë, në llogarinë e KfW-së në *Frankfurt am Main*, Republika e Gjermanisë, numër IBAN: DE 09 5002 0400 3102 5608 01, që përcakton datën e kërkueshme si referencë shtesë (ref.: VVVVMMDD).

7.4 *Kundërpretendimet e huamarrësit*. Huamarrësi nuk ka të drejtë të ngrejë asnjë pretendim mbajtjeje ose kompensimi apo të drejta të ngjashme ndaj detyrimeve për pagesa sipas kësaj marrëveshjeje, nëse këto të drejta nuk njihen nga një gjykim deklarues, ose nuk miratohen nga KfW-ja.

7.5 *Kamatëvonesa*. Nëse ndonjë këst shlyerjeje ose parapagim, në pajtim me nenin 6.4 (parapagim), nuk janë në dispozicion të KfW-së kur bëhen të kërkueshme, KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të caktojë kamatëvonesë në normën prej 200 pikësh bazë mbi normën e interesit në vit, të përcaktuar në nenin 5 (interesi), për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që përfundon në datën kur këto pagesa kreditohen në llogarinë e KfW-së, të specifikuar në nenin 7.3 (numri i llogarisë, koha e kreditimit). Kjo kamatëvonesë duhet paguar menjëherë pas kërkesës së parë të KfW-së.

7.6 *Kompensimi me shumë të plotë*. Për shumën e prapambetura (me përjashtim të kësteve të shlyerjeve dhe të parapagimeve të përmendura në nenin 7.5 (interesi i papaguar), KfW-ja, pa njoftim



paraprak, mund të kërkojë kompensim në shumë të plotë nga data e kërkueshme deri në datën e pagesës me një normë prej 200 pikësh bazë në vit mbi normën fikse të interesit, në bazë të nenit 5 (*interes*). Kompensimi me shumë të plotë duhet paguar menjëherë pas kërkesës së parë të KfW-së. Huamarrësi është i lirë të tregojë se nuk ka pasur asnjë dëmtim ose që dëmtimet ishin më të vogla sesa kompensimi me shumë të plotë.

7.7 *Kompensimi*. KfW-ja gëzon të drejtën e kompensimit të pagesave të marra kundrejt pagesave të kërkueshme në kuadër të kësaj marrëveshjeje dhe në kuadër të marrëveshjeve të tjera të huas të lidhura ndërmjet KfW-së dhe huamarrësit.

7.8 *Llogaritë e bëra nga KfW-ja*. Në mungesë të gabimeve të dukshme, vlerat e llogaritura nga KfW-ja dhe llogaritjet e kryera nga KfW-ja të shumave të kërkueshme në lidhje me këtë marrëveshje huaje përbëjnë të dhëna provuese *prima facie*.

8. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë

KfW-ja merr garanci për pretendimet e pagesës në kuadër të kësaj marrëveshjeje nga Republika Federale e Gjermanisë përpara disbursimit të parë.

9. Paligjshmëria

Nëse në çdo juridiksion të zbatueshëm është e paligjshme për KfW-në që të kryejë ndonjë prej detyrimeve të saj të parashikuara në këtë marrëveshje ose për të financuar, ose mbajtur huan KfW-ja njofton huamarrësin se:

a) zotimi financiar i KfW-së do të anulohet menjëherë; dhe

b) huamarrësi do të paguajë vetëm shumat e disbursuara dhe që nuk janë shlyer ende në datën e përcaktuar nga KfW-ja në njoftimin e dërguar për huamarrësin (jo më parë se ditën e fundit të çdo periudhe lehtësuese të zbatueshme, të lejuar me ligj).

Për të shmangur ndonjë dyshim, çdo anulim do të jetë objekt i nenit 3.6 (*tarifa e mospërdorimit*) dhe çdo pagesë e huas përbën parapagim dhe do të jetë objekt i dispozitave të përcaktuara në nenin 6.4/c (*tarifa e parapagimit*) dhe “d” (*shumat e kërkueshme*).

10. Kostot dhe tarifat publike

10.1 *Ndalimi i zbritjeve ose i mbajtjeve*. Huamarrësi kryen të gjitha pagesat sipas kësaj marrëveshjeje pa asnjë zbritje për taksat, detyrimet e tjera publike ose kosto të tjera. Në rast se huamarrësi është i detyruar me ligj ose nga shkaqe të tjera që t'i kryejë këto zbritje, ose mbajtje për pagesat, huamarrësi paguan

çdo shumë shtesë të nevojshme, në mënyrë që KfW-ja të marrë në mënyrë të plotë të gjitha shumat e kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje pas zbritjes së taksave dhe tarifave.

10.2 *Kostot*. Huamarrësi do të mbulojë të gjitha shpenzimet dhe kostot që shkaktohen në lidhje me disbursimin dhe shlyerjen e huas, veçanërisht kostot e remitancave dhe transferimit (duke përfshirë tarifatat e konvertimit), si dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet që shkaktohen në lidhje me mbajtjen ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me këtë marrëveshje, si dhe të drejtave që burojnë prej saj.

10.3 *Taksa dhe detyrime të tjera*. Huamarrësi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që shkaktohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, mbi lidhjen dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Nëse KfW-ja parapaguan këto taksa ose detyrime, huamarrësi do t'i transferojë ato pa vonesë, me kërkesë, në llogarinë e KfW-së të përcaktuar në nenin 7.3 (*numri i llogarisë, koha e kreditimit*), ose në ndonjë llogari tjetër të përcaktuar nga KfW-ja.

11. Detyrime të veçanta

11.1 *Zbatimi i programit dhe informacioni specifik*. Huamarrësi, do të garantojë që agjencia e ekzekutimit të projekteve:

a) do të përgatitë, zbatojë, operojë dhe ruajë projektin në pajtim me praktikën e qëndrueshme financiare dhe teknike, në pajtim me standardet mjedisore dhe sociale, dhe kryesisht në pajtim me konceptin e projektit të rënë dakord ndërmjet agjencisë së ekzekutimit të projekteve dhe KfW-së;

b) do t'ia caktojë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të projektit inxhinierëve konsulentë ose konsulentëve të kualifikuar, të pavarur dhe zbatimin e projektit firmave të kualifikuara;

c) do të përmbushë kurdoherë dispozitat e prokurimit të parashikuara në marrëveshjen e veçantë, duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

d) do t'i japë mundësinë, në çdo kohë, KfW-së dhe agjentëve të saj që të inspektojnë ata libra dhe regjistra dhe të gjithë dokumentacionin tjetër të lidhur me zbatimin dhe operimin e projektit, si dhe të vizitojnë projektin dhe të gjitha instalimet e lidhura me të;

e) merr masa që përfaqësuesit e KfW-së të jenë gjithmonë në gjendje të inspektojnë librat dhe regjistrat, dhe të gjithë dokumentacionin përkatës



për zbatimin dhe operimin e projektit, dhe për të vizituar projektin dhe instalimet në lidhje me të;

f) i jep KfW-së çdo informacion dhe të dhënat mbi projektin dhe progresin e tij të mëtejshëm sipas kërkesës së KfW-së.

11.2 *Detajet e zbatimit të projektit.* Agjencia e ekzekutimit të projekteve dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet që kanë të bëjnë me nenin 11.1 (*zbatimi i projektit dhe informacioni special*) i këtushëm nga marrëveshja e veçantë, e cila gjithashtu do të nënshkruhet siç lexohet dhe pranohet nga huamarrësi, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

11.3 *Detyrime të përbashkëta lidhur me projektin.* Huamarrësi do të sigurojë dhe do të sigurojë që agjencia e ekzekutimit të projekteve do të:

a) sigurojë financimin e plotë të projektit dhe t'i japë KfW-së, sipas kërkesës së tij, prova që vërtetojnë se kostot që nuk paguhet nga kjo kredi janë të mbuluara;

b) menjëherë dhe me iniciativën e vet:

i. i kalon KfW-së çdo pyetje të marrë nga huamarrësi ose agjencia e ekzekutimit të projekteve nga OECD-ja, ose anëtarët e saj sipas të ashtuquajturës “Marrëveshje për transparencë të kredive të palidhura ODA”, pas dhënies së kontratave për furnizimet dhe shërbimet që duhet të financohen nga huaja dhe do të bashkërendojë përgjigjen për çdo pyetje të tillë me KfW-në; dhe

ii. njofton KfW-në për çdo rrethanë që cenon ose rrezikon seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e projektit.

11.4 *Detaje të zbatimit të projektit.* Huamarrësi do të mbështesë agjencinë projektkezekutuese në zbatimin e projektit dhe në kryerjen e detyrimeve të agjencisë projektkezekutuese sipas kësaj marrëveshjeje dhe, në veçanti, do t'i japë agjencisë projektkezekutuese çdo dhe të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit.

11.5 *Sigurimi i përpunshmërisë.* Huamarrësi merr përsipër të zbatojë kurdoherë detyrimet e parashtruara në shtojcën 2 (*zotimet e përpunshmërisë së huamarrësit*) dhe të sigurojë që agjencia e ekzekutimit të projekteve të zbatojë kurdoherë detyrimet përkatëse të përcaktuara në marrëveshjen e veçantë.

11.6 *Transporti i furnizimeve.* Dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen qeveritare që janë të njohura për huamarrësin, zbatohen për transportin e mallrave që financohen nga huaja.

11.7 *Renditja pari passu.* Huamarrësi garanton dhe merr përsipër të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj marrëveshjeje huaje dhe do të marrë shërbime në të njëjtin nivel prioriteti (*pari passu*) me të gjitha borxhet e jashtme të pasiguruara dhe jo të varura, dhe huamarrësi do të sigurojë, në masën e lejuar nga ligji, se kjo renditje do të sigurohet për të gjitha borxhet e tjera të jashtme të ardhshme, të pasiguruara dhe jo të varura. Në këtë marrëveshje, **“Borxh i jashtëm”** nënkupton një detyrim të huamarrësit, i cili:

i. rregullohet nga një sistem ligjesh të ndryshëm nga ai i huamarrësit; ose

ii. paguhet në një monedhë të ndryshme nga monedha e vendit të huamarrësit; ose

iii. i paguhet një personi që është themeluar, ka vendbanim, është rezident, ka selinë ose zyrat qendrore të biznesit jashtë territorit të vendit të huamarrësit.

11.8 *Pengu negativ.* Huamarrësi do të sigurojë që agjencia e ekzekutimit të projekteve nuk do të krijojë apo lejojë të nënshtrojë asnjë akuzë mbi pasuritë e projektit pa pëlqimin paraprak të KfW-së. Nëse ndonjë nga pasuritë e projektit shitet ose asgjësohet ndryshe, huamarrësi do të sigurojë që agjencia e ekzekutimit të projekteve do të sigurojë që asnjë akuzë nuk do të krijohet apo lejohet të subsistojë në një pasuri të tillë të projektit pa pëlqimin paraprak të KfW-së. Në këtë marrëveshje “Barrë” do të thotë çdo hipotekë, peng, barrë, detyrim apo transferim me anë të garancisë, hipotekës apo interesi të garancisë dhe çdo marrëveshje apo angazhim tjetër, efekti i së cilës në këtë marrëveshje. “Akuzë” do të thotë çdo hipotekë, zotim, lidhje, akuzë, caktim ose transferim me anë të sigurimit, hipotekimit apo interesit të sigurisë dhe çdo marrëveshje apo marrëveshje tjetër, efekti i së cilës është krijimi i një sigurie ose çdo të drejte që i jep përparësi pagesës, në lidhje me çdo detyrim të çdo personi.

Ky detyrim nuk zbatohet për:

a) barra ekzistuese apo për të cilat është rënë dakord kur kjo marrëveshje është nënshkruar dhe KfW-ja është njoftuar para nënshkrimit të marrëveshjes;

b) barrët që janë krijuar në ushtrimin e biznesit, sipas rregullave ligjore apo rregullave të tjera kontraktuale për të siguruar detyrimet (me përjashtim të detyrimeve të huas), ndaj furnitorit apo ofruesve të tjerë të shërbimeve (p.sh. mbajtjen e të



drejtave për titullin në industri dhe barrën ligjore); ose

c) barrët që ekzistojnë në kohën kur u ble një pasuri, me kusht që këto barrë të hiqen tre muaj pas marrjes.

Nëse huamarrësi, nëpërmjet MIP-it, i jep garanci palës së tretë ose të drejta të tjera që i mundësojnë palës së tretë të ketë preferenca apo pretendime ndaj ndonjëres prej asetëve, pasurive, pronave apo të ardhurave të projektit të huamarrësit, KfW-ja mund të japë pëlqimin për huamarrësin, duke i dhënë KfW-së garancinë (shtesë) në të njëjtën masë që siguron/garanton pretendimet e KfW-së ndaj huamarrësit në pajtim me këtë marrëveshje huaje.

11.9 *Disponimi i asetëve*. Huamarrësi do të sigurojë që agjencia e ekzekutimit të projekteve nuk do të shesë ose të asgjësojë ndryshe asnjë pasuri të projektit pa pëlqimin paraprak të KfW-së.

12. Arsyet e zgjidhjes

Zgjidhja e marrëveshjes

12.1 *Arsyet e zgjidhjes*. KfW-ja mund të ushtrojë të drejtat e parashikuara në nenin 12.2 (*pasojat ligjore të ndodhjes së një arsyeje për zgjidhjen e marrëveshjes*), nëse lind një rrethanë që përbën shkak të rëndësishëm. Këtu përfshihen në veçanti rastet e mëposhtme:

a) huamarrësi nuk përmbush detyrimet ndaj KfW-së për të kryer pagesat kur bëhen të kërkueshme;

b) detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje apo marrëveshjes së veçantë, si dhe sipas marrëveshjeve të tjera shtesë që janë të detyrueshme ligjorisht në lidhje me këtë marrëveshje, janë shkelur;

c) kjo marrëveshje ose ndonjë pjesë e saj pushon së pasuri efekt detyrues ndaj huamarrësit ose nuk mund të jetë më e zbatueshme ndaj huamarrësit;

d) çdo deklaratë, konfirmim, informacion, përfaqësim apo garanci e konsideruar nga KfW-ja si thelbësore për dhënien dhe ruajtjen e huas, rezulton e rreme, e gabuar dhe e paplotë;

e) ndodhin rrethana të tjera të jashtëzakonshme që vonojnë ose përjashtojnë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje;

f) agjencia e ekzekutimit të projekteve nuk mund të provojë se shumata e huas janë përdorur për qëllimin e caktuar;

g) huamarrësi nuk është më në gjendje të vazhdojë kryerjen e pagesave ndaj kreditorëve, nuk ka aftësi paguese ose fillon bisedime me një ose më shumë kreditorë të huamarrësit për një moratorium,

heqjen dorë nga borxhet e mbetura, ose zgjidhjen apo mosvazhdimin e shërbimit të borxhit;

h) KfW-ja ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e grantit të dhënë sipas marrëveshjes së grantit WBIF ose të pezullojë disbursimet në bazë të saj.

12.2 *Pasojat ligjore të ndodhjes së arsyes për përfundim*. Nëse ka ndodhur një prej rasteve të përmendura në nenin 12.1 (*arsyet për përfundim*), KfW-ja mund t'i pezullojë menjëherë disbursimet sipas kësaj marrëveshjeje. Nëse ky rast nuk është zgjidhur brenda një periudhe prej pesë ditësh (në rastin e nenit 12.1/a) ose në të gjitha rastet e tjera të specifikuar në nenin 12.1 (*arsyet për përfundim*), brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, që gjithsesi duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja mund ta zgjidhë këtë marrëveshje tërësisht ose pjesërisht, me pasojën e heqjes së detyrimeve të saj sipas kësaj marrëveshjeje dhe KfW-ja mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme, të plotë ose të pjesshme, të shumës së papaguar të huas, së bashku me interesin e mbledhur, dhe të gjitha shumata e tjera të kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje. Nenet 7.5 (*interes i papaguar*) dhe 7.5 (*kompensimi me shumë të plotë*) zbatohen për shumata e përshpejtuara *mutatis mutandis*.

12.3 *Kompensimi për dëmet*. Në rast se kjo marrëveshje zgjidhet plotësisht ose pjesërisht, huamarrësi paguan kompensimin e mospërdorimit sipas nenit 3.6 (*kompensimi i mospërdorimit*) dhe/ose kompensimin e pagimit të parakohshëm në pajtim me nenin 6.4/c (*tarifa e parapagimit*).

13. Përfaqësimet dhe deklaratat

13.1 *Përfaqësimi i huamarrësit dhe agjencia e ekzekutimit të projekteve*. Ministri i Financave dhe Ekonomisë e përfaqëson huamarrësin në zbatimin e kësaj, kryetari i Bashkisë së Tiranës i agjencisë së ekzekutimit të projekteve dhe persona të tillë të caktuar prej tij ose të saj në KfW, dhe të autorizuar nga nënshkrimet ekzemplare të autentifikuara prej tij ose të saj, do të përfaqësojnë agjencinë e ekzekutimit të projekteve në zbatimin e projektit dhe ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje. Fuqia e përfaqësimit nuk do të përfundojë nëse nuk është marrë nga KfW-ja revokimi i saj i shprehur nga përfaqësuesi i huamarrësit të autorizuar në atë kohë.

13.2 *Adresat*. Njoftimet dhe deklaratat në lidhje me këtë marrëveshje duhet të jenë me shkrim. Ato duhet të dërgohen si kopje origjinale. Çdo njoftim dhe të gjitha njoftimet ose deklaratat e bëra në lidhje



me këtë marrëveshje duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në:	KfW Postfach 11 11 41 60046 Frankfurt am Main Germany (Gjermani)
Për huamarrësin:	Republika e Shqipërisë Ministria e Financave dhe Ekonomisë Blv. “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3 Tiranë
Për agjencinë e ekzekutimit të projekteve	Bashkia e Tiranës Sheshi Skënderbeu 1001/Tiranë, Shqipëri

14. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me projektin

14.1 *Publikimi i informacioneve lidhur me projektin nga KfW-ja.* Për të përmbushur parimet e pranuar në nivel ndërkombëtar për arritjen e transparencës dhe efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja e bën publik informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe kategorizimit mjedisor dhe social, si dhe raportet e vlerësimit *ex post*) për projektin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë negociatave parakontraktuale, paralelisht me zbatimin e marrëveshjes(ve) të lidhura me projektin dhe me fazën paskontraktuale (në vijim referuar si “Periudha e plotë”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e Bankës për Zhvillim të KfW-së: (<https://www.kfw.de/microsites/Microsite/transparenz.kfw.de/#/start>).

Publikimi i informacionit (ose nga KfW-ja, ose nga palët e treta, në pajtim me nenin 14.3 për *(transferimin e informacioneve lidhur me projektin te palët e treta dhe publikimi i tyre)*) më poshtë, në lidhje me projektin dhe financimin e tij, nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të detajuar sensitiv financiar ose biznesi, në lidhje me palët e përfshira në projekt, ose financimin e tij, të tilla si:

- informacion për të dhëna të brendshme financiare;
- strategji biznesi;
- udhëzime dhe raporte të brendshme;
- të dhëna personale të personave fizikë;

e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për pozicionin financiar të palëve.

14.2 *Transferimi i informacionit të lidhur me projektin te palët e treta.* KfW-ja e ndan informacionin e përzgjedhur për projektin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë periudhës së plotë me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet:

- degët e KfW-së;
- Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë apo subjektet kompetente;

c) organizata të tjera zbatuese, të përfshira në bashkëpunimin e zhvillimit dypalësh gjerman, veçanërisht *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*;

d) organizatat ndërkombëtare të angazhuara në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe anëtarët e saj; Klubi i Parisit dhe anëtarët e tyre përkatës (duke përfshirë, për të shmangur çdo dyshim, pjesëmarrësit dhe vëzhguesit e Klubit të Parisit);

e) palët në kushtet e përgjithshme, të datës 7 nëntor 2006, të Fondit të Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor (EWBJF);

- institucionet që administrojnë EWBJF-në;
- Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij; dhe

h) agjencinë e ekzekutimit të projekteve.

14.3 *Transferimi i informacioneve lidhura me projektin te palët e treta dhe publikimi i tyre.* Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për projektin dhe mënyrën e tij të financimit përgjatë periudhës së plotë, me subjektet e mëposhtme që botojnë artikuj të lidhur me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë, për qëllimet e Nismës Ndërkombëtare për Transparencë të Ndihmës

(<https://www.bmz.de/en/ministry/facts-figures/project-and-organisation-data>);

b) Tregu & Investimi Gjerman (GTAI), për qëllimet e informacionit për tregun (<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/welcome.html>);

c) OECD-ja, për qëllimin e raportimit të rrjedhës financiare, në kuadër të zhvillimit të bashkëpunimit (<https://www.oecd.org/>);



d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEVal), për qëllime të zhvillimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman, për të garantuar transparencën dhe eficiencën (<https://www.deval.org/en/>);

e) palët në kushtet e përgjithshme, të datës 7 nëntor 2006, të Fondit të Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor (“EWBJF”);

f) institucionet që administrojnë EWBJF-në;

g) Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij.

14.4 *Transferimi i informacioneve, lidhur me projektin, palëve të treta (përfshirë publikimin e tyre)*. KfW-ja rezervon më tej të drejtën për transferimin (duke përfshirë qëllimet e publikimit) e informacionit për projektin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë periudhës së plotë të palët e tjera të treta, për të mbrojtur interesat e ligjshme.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja tek palët e treta, nëse interesat e ligjshme të huamarrësit ose agjencisë së zbatimit të projektit në informacionin që nuk transferohet, i tejkalojnë interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshme të huamarrësit dhe agjencisë së zbatimit të projektit, në veçanti përfshijnë konfidencialitetin e informacioneve sensitive të përmendura në nenin 14.1 (*publikimi i informacioneve lidhur me projektin nga KfW-ja*), i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacion për palët e treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave ligjore ose rregulloreve ose për të mbrojtur pretendimet, ose të drejtat e tjera ligjore në gjykatë apo procedime administrative.

15. Dispozita të përgjithshme

15.1 *Dita bankare*

“**Ditë bankare**” nënkupton çdo ditë (përveç të shtunës dhe të dielës) në të cilën bankat tregtare janë hapur për punë në *Frankfurt am Main*, Gjermani, me kusht që për të përcaktuar datën e shlyerjes dhe datën e pagesës, në lidhje me huan e parashikuar këtu dhe për të përcaktuar datat e disbursimit apo të pagesave të tjera, kjo ditë duhet të jetë edhe ditë TARGET (Sistemi i Automatizuar Transevropian për Transferimet Ekspres të Likuidimit Bruto).

“**Ditë TARGET**” nënkupton çdo ditë në të cilën Sistemi i Automatizuar Transevropian për Transferimet Ekspres të Likuidimit Bruto (TARGET) është i hapur për likuidimin e pagesave.

15.2 *Paprekshmëria e fondeve*. Sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, fondet, pagesat, pasuritë që i nënshtrohen kësaj marrëveshjeje, të destinuara dhe të adresuara ndaj huamarrësit, sipas qëllimit të përcaktuar në të, duke përfshirë këtu por pa u kufizuar në, të gjitha mallrat materiale dhe jomateriale që rrjedhin prej tyre, nuk janë subjekt i konfiskimit, ngrirjes së dënimit, apo ndonjë forme tjetër paraburgimi si pasojë e një veprimi të zbatimit të ligjit kundër huamarrësit ose që rezultojnë nga masa të tjera gjyqësore në favor të palëve të treta. Në të njëjtën kohë, huamarrësi nuk mund të privohet nga pagesa apo kontributet nga KfW-ja, si rezultat i procedurave të konfiskimit, ngrirjes së urdhrat apo një urdhërzbatimi nga një gjykatë shqiptare pa një hetim të plotë dhe një seancë të qenësishme të huamarrësit përpara një gjykate shqiptare, dhe një vendimi përfundimtar që po merret nga kjo e fundit, i cili ka marrë në konsideratë të gjitha burimet ligjore.

15.3 *Vendi i ekzekutimit të marrëveshjes*. Vendi i përbushjes së të gjitha detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje është *Frankfurt am Main*, Republika Federale e Gjermanisë.

15.4 *Pavlefshmëria e pjesëshme dhe boshllëqet*. Nëse një dispozitë e kësaj marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme, ose nëse ekziston një boshllëk në një prej dispozitave të kësaj marrëveshjeje, kjo nuk ndikon në vlefshmërinë e dispozitave të tjera. Palët e kësaj marrëveshjeje e zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë ligjërish të vlefshme që i afrohet sa më shumë të jetë e mundur frymës dhe qëllimit të dispozitës së pavlefshme. Palët plotësojnë çdo boshllëk në dispozita me një dispozitë ligjërish të vlefshme që i afrohet frymës dhe qëllimit të kësaj marrëveshjeje.

15.5 *Formë e shkruar*. Çdo addenda dhe amendament i kësaj marrëveshjeje duhet të jetë me shkrim dhe nuk duhet të kërkojë pëlqimin e agjencisë së ekzekutimit të projekteve. Palët mund të heqin dorë nga kërkesa e formularit të shkruar vetëm me shkrim. Huamarrësi i dërgon agjencisë së ekzekutimit të projekteve një kopje të kësaj marrëveshjeje, si dhe çdo amendament të saj, sa më shpejt që të jetë e mundur, në adresën e korrespondencës, siç thuhet këtu ose në një adresë tjetër të tillë siç është njoftuar nga agjencia e ekzekutimit të projekteve.

15.6 *Transferim i të drejtave*. Huamarrësi nuk mund të delegojë ose transferojë, rëndoje me peng ose



hipotekë ndonjë pretendim nga kjo marrëveshje huaje.

15.7 *Ligji i zbatueshëm.* Kjo marrëveshje rregullohet nga ligji gjerman.

15.8 *Periudha e parashkrimit.* Të gjitha pretendimet e KfW-së, sipas kësaj marrëveshjeje huaje, mbarojnë pesë vjet nga fundi i vitit në të cilin kanë lindur këto të drejta dhe KfW-ja është vënë në dijeni të rrethanave që përbëjnë këtë pretendim ose mund të ishte vënë në dijeni pa neglizhencë flagrante.

15.9 *Heqja dorë nga imuniteti.* Kur huamarrësi, aktualisht ose në të ardhmen, në një juridiksion mund të pretendojë për vete ose për sendet e tij pasurore, imunitet nga padia, ekzekutimi, sekuestrimi ose proces tjetër ligjor dhe në masën që huamarrësi, në mënyrë të pakthyeshme, heq dorë nga ky imunitet për pretendime nga dhe në lidhje me këtë marrëveshje huaje, në masën më të gjerë të lejuar nga ligji i këtij juridiksioni.

Me përjashtim të disa rasteve, huamarrësi nuk heq dorë nga asnjë imunitet, në lidhje me ekzekutimin e ndonjë vendimi arbitrazhi, në lidhje me:

i. “mjediset e misionit” të tashme ose të ardhshme, sipas përcaktimit në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike, të nënshkruar në 1961-shin, “mjediset konsullore” të tashme ose të ardhme, sipas përcaktimit në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruar në 1963-shin ose ndryshe të përdorura nga një diplomat ose mision diplomatik në Shqipëri;

ii. çdo pasuri e paluajtshme që përfshihet në dispozitat e nenit 3, pikat 1–3, të ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22.2.2001, “Mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore”;

iii. çdo fond monetar dhe/ose shumë që është bërë e kërkueshme dhe e paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë, sipas traktateve ndërkombëtare të së drejtës publike, konventave dhe/ose marrëveshjeve të nënshkruara prej saj;

iv. çdo fond ose aset i synuar për qëllime publike, në përputhje me dispozitat e detyrueshme në fuqi të së drejtës ndërkombëtare dhe legjislacionit të huaj.

15.10 *Mosmarrëveshjet ligjore.*

a) *Arbitrazhi.* Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga ose në lidhje me këtë marrëveshje huaje, zgjidhen vetëm dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Në këtë aspekt, zbatohen sa më poshtë:

i. Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga një ose tre arbitra që emërohen dhe veprojnë në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) që ndryshohet herë pas here;

ii. Gjykimet në arbitrazh kryhen në *Frankfurt am Main*. Gjykimet zhvillohen në gjuhën angleze.

15.11 *Hyrja në fuqi.* Kjo marrëveshje huaje hyn në fuqi jo më parë se huamarrësi të ketë informuar KfW-në me shkrim se procedurat e brendshme ligjore që huamarrësi duhet të përmbushte, janë plotësuar (data e marrjes në dorëzim nga KfW-ja). KfW-ja duhet të njoftojë huamarrësin në formë të shkruar rreth datës së marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se marrëveshja e huas nuk ka hyrë në fuqi pas gjashtë muajve pas datës së nënshkrimit të saj ose pas kalimit të afateve të tjera të rëna dakord nga KfW-ja, deri në datën e hyrjes në fuqi, KfW-ja do të ketë të drejtën të tërhiqet në mënyrë të njëanshme nga kjo marrëveshje huaje dhe të përfundojë pezullimin e saj, duke i dërguar huamarrësit njoftim me shkrim.

Hartuar në 2 (dy) kopje origjinale, në gjuhën angleze.

Tiranë,
Datë: 28 dhjetor 2023

Frankfurt am Main,
Datë: 28 dhjetor 2023

Republika e Shqipërisë

KfW-ja

Përfaqësuar nga Ministria
e Financave
dhe Ekonomisë
Emri: Ervin Mete

Emri: Arne Gooss

Titulli: Ministër i
Financave dhe Ekonomisë

Titulli: *Head of Division*

Emri: Brit Horschke
Titulli: *KfW Country
Director*



Shtojca 1

GRAFIKU I DISBURSIMIT

Grafiku më i shpejtë i mundshëm i disbursimit

Deri në fund të çdo periudhe disbursimi (“Data efektive e përfundimit të periudhës”, në përputhje me listën e mëposhtme), huamarrësi mund të kërkojë disbursime deri në një masë që nuk tejkalon shumën kumulative të disbursimeve të përcaktuara në tabelën e mëposhtme.

Periudha	Data efektive e fillimit të periudhës (përfshirë)	Data efektive e përfundimit të periudhës (përfshirë)	Shuma maksimale që mund të disbursohet deri në fund të periudhës (kumulative) (të gjitha shifrat në euro)
1	1.1.2024	1.7.2024	1.100.000,00
2	1.7.2024	1.1.2025	1.100.000,00
3	1.1.2025	1.7.2025	4.100.000,00
4	1.7.2025	1.1.2026	7.900.000,00
5	1.1.2026	1.7.2026	9.900.000,00
6	1.7.2026	1.1.2027	12.100.000,00
7	1.1.2027	1.7.2027	19.450.000,00
8	1.7.2027	1.1.2028	29.450.000,00
9	1.1.2028	1.7.2028	39.450.000,00
10	1.7.2028	30.12.2029	50.000.000,00

Shtojca 2

ZOTIMET E PËRPUTHSHMËRISË
SË HUAMARRËSIT

1. PËRKUFIZIME

Praktikë shtrënguese: është dëmi ose dëmtimi, ose kërcërimi për t’i shkaktuar dëm ose dëmtuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndonjë personi ose pasurie të personit, me qëllim që të ndikojë në mënyrë të parregullt në veprimet e një personi.

Praktikë e fshehtë: është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë personave, e hartuar për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e gabuar të veprimeve të një personi tjetër.

Praktikë korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja, marrja, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të paligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çdo natyre, ndonjë personi ose nga ndonjë person, me qëllim ndikimin në veprimet e ndonjë personi ose që shkaktojnë që ndonjë person të përmbahet nga një veprim i caktuar.

Praktikë mashtruese: çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë keqinterpretimin që me vetëdije ose nga pakujdesia mashtron, ose synon të mashtrtojë një person për të marrë përfitim financiar ose për të shmangur një detyrim.

Lista e BE-së: Lista e BE-së, e juridiksioneve tatimore jobashkëpunuese, siç përcaktohet dhe përditësohet herë pas here nga Komisioni i BE-së, duke përfshirë shtojcën I dhe shtojcën II, të lidhur (për detaje të mëtejshme ju lutemi shikoni: <https://www.consilium.europa.eu/de/policies/eu-list-of-non-cooperative-jurisdictions>).

Shtojca I përfshin juridiksionet që klasifikohen si jobashkëpunuese dhe shtojca II përfshin juridiksione të mëtejshme (*Annexe II Jurisdictions’ose ‘Jurisdictions Committed Jurisdictions’*) që kanë marrë angazhime të mjaftueshme për të trajtuar mangësitë e tyre të identifikuara dhe si të tilla nuk janë konsideruar si jo bashkëpunuese për momentin.

Praktikë penguese: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e materialit të provave për hetim ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar në akuzat për një praktikë korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë, ose kërcërimi, ngacmimi apo frikësimi i ndonjë pale për ta parandaluar atë nga zbulimi i njohurive të saj për çështjet që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit;

ose ii. veprime me qëllimin për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar me kontratë, në lidhje me hetimin zyrtar në akuzat e një praktike korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë.



Person: çdo person fizik, person juridik, ortakëri ose shoqatë e pathemeluar.

Praktikë e sanksionueshme: çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktikë mashtruese ose praktikë penguese (siç janë përcaktuar në këtë marrëveshje), e cila: i. është e paligjshme sipas ligjit gjerman ose ndonjë ligji tjetër të zbatueshëm; dhe ii. ka ose mund të ketë efekt material ligjor, ose reputacional në marrëveshjen ndërmjet huamarrësit dhe KfW-së, ose në zbatimin e saj.

Sanksione: ligjet, rregulloret, embargot ose masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, (duke përfshirë mallrat, teknologjitë apo shërbimet dhe ndihmën financiare në lidhje me to) të administruara, të miratuara ose të zbatuara nga ndonjë organ sanksionues.

Organ sanksionues: cilido nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

Listë e sanksioneve: çdo listë e personave, grupeve ose subjekteve të caktuara posaçërisht, të cilat janë objekt i sanksioneve të lëshuara nga ndonjë organ sanksionues.

Praktika e shmangies tatimore: çdo akt i përfitimit të teknikaliteteve të një sistemi tatimor dhe/ ose juridiksioni, ose i mospërputhjeve midis dy ose më shumë sistemeve tatimore dhe/ose juridiksioneve pa ndonjë arsye të shëndoshë biznesi, përveç qëllimit të vetëm të reduktimit të përgjegjësisë tatimore.

2. SIPËRMARRJET PËR INFORMIM

Huamarrësi, do të:

a) vendosë menjëherë në dispozicion të KfW-së, me kërkesë, informacion përkatës mbi “njoh klientin tënd” ose informacione të ngjashme në lidhje me huamarrësin, siç mund të kërkohej nga KfW-ja;

b) t’i paraqesë menjëherë KfW-së, me kërkesë, të gjitha informacionet dhe dokumentet e projektit që lidhen me huamarrësin dhe kontraktorët (nënkontraktorët) e tij dhe palëve të tjera të lidhura që KfW-ja kërkon të përmbushë detyrimet e saj për të parandaluar praktikën e sanksionueshme, pastrimin e parave ose/dhe financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me huamarrësin, të nevojshme për këtë qëllim;

c) informon menjëherë KfW-në dhe me pëlqimin e vet, sapo të njihet ose dyshohet për ndonjë praktikë të sanksionueshme, veprim të pastrimit të

parave dhe/ose financim të terrorizmit që lidhet me projektin;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) i mundëson KfW-së dhe agjentëve të saj inspektimin në çdo kohë të dokumentacionit të huamarrësit dhe palëve të tij (nën)kontraktore apo palëve të tjera të lidhura me të mbi projektin dhe kryerjen e vizitave për projektin, dhe të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce;

f) informon menjëherë KfW-në dhe me pëlqimin e vet, në rast se huamarrësi ka ndërmend të caktojë fondet e dhëna nga KfW-ja për (nën)kontraktimin dhe/ose palët e tjera të lidhura me të, të cilat ndodhen dhe/ose regjistrohen në çdo vend të listuar në juridiksione jobashkëpunuese si të shtojcës I, të listës së BE-së;

g) informon menjëherë KfW-në dhe, me pëlqimin e vet, sapo të bëhet i vetëdijshëm ose dyshon për ndonjë praktikë të shmangies së taksave lidhur me projektin.

3. DEKLARIMI DHE GARANCIA

Në lidhje me ligjin gjerman ose ligjin e vendit të huamarrësit, huamarrësi deklaron se asnjë person që vepron në emër të huamarrësit me projektin, nuk ka kryer ose kryen praktika të sanksionueshme, pastrim parash ose financim terrorizmi.

Deklarimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen bëhet për herë të parë nëpërmjet ekzekutimit të kësaj marrëveshjeje. Do të konsiderohet të përsëritet pas çdo tërheqjeje të huas dhe në çdo datë të pagesës së interesit, në secilin rast, duke iu referuar rrethanave që mbizotërojnë në atë datë.

4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Huamarrësi merr përsipër, menjëherë pasi huamarrësi ose KfW-ja vihen në dijeni ose dyshojnë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, veprim të pastrimit të parave ose financim të terrorizmit, ose ndonjë praktikë shmangie tatimore, që të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, për të konstatuar nëse ka ndodhur një incident i tillë përputhshmërie. Huamarrësi, në veçanti, do të përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme për çdo njoftim nga KfW-ja dhe do të ofrojë mbështetje të dokumentuar për përgjigjen e tillë sipas kërkesës së KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Huamarrësi ndërmerr:



a) të sigurojë që, në lidhje me projektin, aktivitetet e tij nuk do të lindin asnjë praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim të terrorizmit;

b) të mos hyjë në ndonjë transaksion ose të angazhohet drejtpërdrejt, ose tërthorazi në ndonjë veprimtari tjetër në lidhje me projektin që do të përbënte shkelje të sanksioneve; dhe

c) të mos ndajë fondet e dhëna nga KfW-ja për asnjë person të vendosur dhe/ose të regjistruar në ndonjë juridiksion të mbajtur në shtojcën I, të listës së BE-së, pa pëlqimin paraprak të KfW-së dhe nuk do të angazhohet në asnjë aktivitet tjetër që do të përbënte një praktikë të shmangies tatimore.

DEKRET**Nr. 195, datë 27.5.2024****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 44/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për financimin e projektit “Transporti i gjelbër i Tiranës”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

UDHËZIM**Nr. 10, datë 25.5.2024****PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 8, DATË 3.5.2024, “PËR
PROCEDURAT E PRANIMIT, TË
PEZULLIMIT DHE TË LARGIMIT TË
MËSUESIT NGA NJË VEND PUNE, SI
DHE ADMINISTRIMIT TË PORTALIT
‘MËSUES PËR SHQIPËRINË’”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të nenit 60, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Shtojca nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e udhëzimit nr. 8, datë 3.5.2024, “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”, zëvendësohet me shtojcën bashkëlidhur.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, njësitë arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Nina Guga**

SHTOJCA 2**KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE
PËR LËVIZJET PARALELE**

1	Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare e studimeve të barasvlershme me to. Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: Nota mesatare 5.00 - 5.50 = 0.5 pikë. Nota mesatare 5.51 - 6.00 = 1 pikë. Nota mesatare 6.01 - 6.50 = 1.5 pikë. Nota mesatare 6.51 - 7.00 = 2 pikë. Nota mesatare 7.01 - 7.50 = 2.5 pikë. Nota mesatare 7.51 - 8.00 = 3 pikë. Nota mesatare 8.01 - 8.50 = 3.5 pikë.	0.5-5 pikë
---	---	------------



	<p>Nota mesatare 8.51 - 9.00 = 4 pikë. Nota mesatare 9.01 - 9.50 = 4.5 pikë. Nota mesatare 9.51 - 10.00 = 5 pikë.</p>	
2	<p>Kategoria e kualifikimit: a) Mësues i Kualifikuar (kategoria III) 1-4 pikë (1 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 2 pikë për vlerësimin “Mirë”, 3 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe 4 pikë për vlerësimin “Shkëlqyeshëm”) b) Mësues Specialist (kategoria II) 5-7 pikë (5 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 6 pikë për vlerësimin “Mirë”, 7 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”) c) Mësues Mjeshtër (kategoria I) 8-10 pikë (8 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 9 pikë për vlerësimin “Mirë”, 10 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”) Për kandidatët që nuk e kanë në dëshmi nivelin e vlerësimit, do të llogaritet niveli “Shumë mirë”. Kandidati vlerësohet vetëm për kategorinë më të lartë të kualifikimit që zotëron. Kandidati që nuk ka kategori kualifikimi vlerësohet me zero pikë.</p>	0-10 pikë
3	<p>Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja: a) Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 1 pikë. b) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 = 1 pikë. c) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 2 pikë. Dokumenti i gjuhës së huaj duhet të jetë lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për ofrimin e testeve ndërkombëtare dhe të jetë brenda afatit të vlefshmërisë. Lista e subjekteve është sipas udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, i ndryshuar. Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë 2 pikë në vlerësimin e dosjes. Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për dëshminë me vlerësimin më të lartë. Kandidatit të profilit gjuhë e huaj, i njihen pikët e kësaj rubrike, përveç gjuhës së huaj për të cilën është diplomuar. Kandidati që nuk zotëron dëshmi të gjuhës së huaj, vlerësohet me zero pikë.</p>	0-2 pikë
4	<p>Trajnime. Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: a) Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin. i. 1 kredit = 1 pikë. ii. 2 kredite = 2 pikë iii. mbi 3 kredite = 3 pikë. Kandidati që nuk zotëron certifikata trajnimi, vlerësohet me zero pikë.</p>	0-3 pikë
5	<p>Përvoja në punë si mësues dhe/ose drejtues institucioni arsimor. Kandidati që nuk përvojë punë si mësues dhe/ose drejtues institucioni arsimor, vlerësohet me zero pikë.</p>	0.25 pikë për çdo vit pune
6	<p>Vlerësimi i përfaqësuesve të prindërve (sipas shtojcës 5) . Përfaqësuesit e prindërve të nxënësve, ku mësuesi jep mësim, vlerësojnë punën e këtij mësuesi me nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët”, si vijon: Vlerësimi “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë. Vlerësimi “Mjaftueshëm” = 1 pikë. Vlerësimi “Dobët” = 0 pikë.</p>	0-2 pikë
7	<p>Vlerësimi nga punonjësi/it e shërbimit psiko-social. Punonjësi/it e shërbimit psiko-social vlerësojnë punën e mësuesit me nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët” si vijon: Vlerësimi “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë. Vlerësimi “Mjaftueshëm” = 1 pikë. Vlerësimi “Dobët” = 0 pikë</p>	0-2 pikë
8	<p>Vlerësimi i drejtorit të institucionit arsimor, bazuar në vlerësimin e performancës, e shprehur në nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët”, si vijon: Vlerësimi: “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë. Vlerësimi: “Mjaftueshëm” = 1 pikë. Vlerësimi: “Dobët” = 0 pikë.</p>	0-2 pikë



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË
NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 32850/16

ILIRIA SHPK
kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 2 prill 2024, si Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *President,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit,*

duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 32850/16) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”) më 28 maj 2016 nga një shoqëri italiane, Iliria sh.p.k. (në likuidim) (“shoqëria kërkuese”), të regjistruar në Napoli dhe të përfaqësuar nga z. A. Saccucci, avokat i licencuar në Romë;

vendimin për të njoftuar për kërkesat sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës në lidhje me sigurinë juridike dhe vonesën në ekzekutimin e një vendimi, Qeverinë e Shqipërisë (“Qeveria”) të përfaqësuar nga Agjentja e asaj kohe znj. A. Hicka dhe më pas nga z. O. Moçka, avokat i përgjithshëm i shtetit;

faktin që Qeveria Italiane nuk ka kërkuar të ushtrojë të drejtën e saj për të ndërhyrë (neni 36 paragrafi 1 i Konventës dhe rregulli 44 paragrafi 1 i rregullores së Gjykatës);

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Çështja në fjalë ka të bëjë me mosnjohjen në Shqipëri të një vendimi të huaj arbitrazhi, të cilin gjykatat e brendshme e gjetën të papajtueshëm me parimet bazë të ligjit shqiptar.

2. Kërkesa e mëparshme e shoqërisë kërkuese në Gjykatë rezultoi në gjetje të shkeljes së paragrafit 1 të nenit 6 për shkak të kohëzgjatjes së procedurave të njohjes (shihni *Iliria sh.p.k. kundër Shqipërisë* [Komiteti], nr. 31011/09, 5 mars 2024).

A. Procesi në arbitrazh

1. Sfondi

3. Më 31 korrik 1990, autoritetet shqiptare miratuan ligjin për mbrojtjen e investimeve të huaja (dekret i Presidiumit të Kuvendit Popullor nr. 7406 “Për mbrojtjen e investimeve të huaja”) dhe ligjin për shoqëritë me kapital të huaj (dekret i Presidiumit të Kuvendit Popullor nr. 7407 “Për shoqëritë me kapital të huaj”).

4. Sipas ligjit për mbrojtjen e investimeve të huaja, investitorët kishin të drejtë të zgjidhnin mosmarrëveshjet me arbitrazh (shihni paragrafin 65 më poshtë).

5. Ligji për shoqëritë me kapital të huaj parashikonte që një person me banim jashtë Shqipërisë, me autorizimin e Këshillit të Ministrave, mund të lidhte një marrëveshje me persona me banim në Shqipëri për të krijuar një shoqëri shqiptare.

6. Neni 5 i ligjit parashikonte që kjo marrëveshje duhej të rregullohej nga ligji shqiptar.

2. Marrëveshja 1991

7. Më 26 mars 1991, shoqëria kërkuese nënshkroi një marrëveshje (“Marrëveshja 1991”) me Qeverinë Shqiptare dhe *ndërmarrjen komunale të plazhëve Durrës* për krijimin e një shoqërie me pronësi të përzier (publike-private) të quajtur “DIF” që do të zhvillonte plazhin e Durrësit. Qëllimi i DIF-it ishte të rehabilitonte plazhin, të ndërtonte infrastrukturë, si: kanalizime, një ujësjellës, rrugë dhe hotele për të akomoduar rreth 70,000 turistë.

8. Marrëveshja rregullohej sipas ligjit zviceran dhe *lex mercatoria*. Sipas saj, ishte marrë miratimi paraprak nga Këshilli i Ministrave, siç kërkohej nga ligji për shoqëritë me kapital të huaj.

9. Mosmarrëveshjet duhej të zgjidheshin me arbitrazh.

10. Më 28 mars 1991, Këshilli i Ministrave miratoi krijimin e DIF-it.

3. Vendimi i arbitrazhit

11. Më 3 shtator 1993, një tribunal ndërkombëtar arbitrazhi i krijuar bazuar në Marrëveshjen 1991 urdhëroi qeverinë shqiptare që t’i paguajë shoqërisë kërkuese 48,239,000,000 lira italiane (“TIL”) dhe një interes vjetor me normë 13% (“vendimi i arbitrazhit”). Procesi dhe arsyet që çuan në gjetjet e gjykatës, të përshkruara në vendim, ishin si më poshtë.

**a) Proces**

12. Në një datë të papërcaktuar, shoqëria kërkuese filloi procesin e arbitrazhit të bazuar në kontratë kundër qeverisë shqiptare dhe caktoi një nga tre arbitrat. Me kërkesë të shoqërisë kërkuese dhe meqenëse Qeveria nuk arriti të caktojë një arbitër, Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (“ICC”) në Paris caktoi arbitrin e dytë, z. F. L., një shtetas shqiptar dhe avokat i licencuar në Tiranë. Dy arbitrat më pas caktuan arbitrin e tretë dhe kryetarin e tribunalit.

13. Shoqëria kërkuese pretendoi se Shqipëria kishte përcaktuar përsëri kufijtë e saj administrativë dhe e kishte ndarë zonën bregdetare që ishte objekt i Marrëveshjes 1991 ndërmjet dy bashkive (Durrësit dhe Kavajës), gjë që e bëri të pamundur investimin. Ajo pretendoi gjithashtu se autoritetet kishin transferuar pronësinë e pjesëve të tokës përkatëse të ish-pronarët e saj dhe/ose të fermerët.

14. Palët shkëmbyen parashtrimet e tyre përkatëse me shkrim. Ndër të tjera, Qeveria parashtrroi se ajo nuk kishte legjitimitet pasiv në proceset e arbitrazhit pasi nuk kishte ndërmarrë asnjë detyrim ndaj shoqërisë kërkuese sipas Marrëveshjes 1991.

15. Në një seancë pajtimi të 3 korrikut 1993, zëvendësministri për Punët Publike u shpreh se të dyja palët në mosmarrëveshje nuk kishin përmbushur detyrimet e tyre dhe u shpreh se autoritetet ishin të gatshme të negocionin përsëri marrëveshjen dhe të mbanin pjesën e tyre të përgjegjësisë deri në 1 miliard lira italiane. Shoqëria kërkuese e refuzoi propozimin.

16. Në seancën dëgjimore të 17 korrikut 1993, shoqëria kërkuese hodhi poshtë si të pabazuar justifikimin e qeverisë që ajo nuk kishte legjitimitet pasiv në proces. Ajo paraqiti një sërë dokumentesh të cilat sipas saj tregonin se Qeveria kishte caktuar disa anëtarë në bordin e drejtorëve të shoqërisë me pronësi të përzier DIF dhe, për rrjedhojë, kishte përmbushur një pjesë të kontratës dhe kishte legjitimitet pasiv.

17. Përveç kësaj, shoqëria kërkuese paraqiti një raport ekspertizë në lidhje me *quantum* të pretendimit të saj.

18. Askush nuk u paraqiti në seancë në emër të Qeverisë.

19. Seanca e 18 korrikut 1993 u shty për shkak të mosparaqitjes së përfaqësuesit të Qeverisë.

20. Seanca dëgjimore e 19 korrikut 1993 u shty me kërkesë të Qeverisë, e cila kërkoi kohë të mjaftueshme për t’iu përgjigjur raportit të ekspertizës në lidhje me *quantum*. Tribunali caktoi shtatë ditë kohë për këtë qëllim.

21. Qeveria paraqiti parashtrime shtesë me shkrim më 27 korrik 1993, megjithatë nuk paraqiti asnjë parashtrim në lidhje me *quantum*.

22. Në seancën përfundimtare të datës 2 shtator 1993, shoqëria kërkuese ritheksoi pretendimin e saj në lidhje me shkeljet e Marrëveshjes 1991 nga ana e Qeverisë, ndërsa Qeveria këmbënguli se ajo nuk kishte legjitimitet pasiv në proces.

b) Arsyet

23. Për aq sa ishte e rëndësishme, tribunalin u mbështet në arsyet e mëposhtme për të vendosur në favor të shoqërisë kërkuese.

24. Ai vuri në dukje se megjithëse qeveria shqiptare nuk i kishte kundërshtuar shkeljet e pretenduara të Marrëveshjes 1991, tribunalin duhej të konstatoje në njëfarë mase se ato në fakt kishin ndodhur.

25. Tribunalin konstatoi se Qeveria nuk kishte dhënë një garanci bankare që i kërkohej në bazë të marrëveshjes para fillimit të punimeve. Gjithashtu Qeveria e kishte ndarë në mënyrë administrative zonën e investimit mes dy rrethëve të ndryshme të Durrësit dhe Kavajës dhe një pjesë të zonës ia kishte dhënë fermerëve dhe personave të tjerë privatë. Në këtë mënyrë, tribunalin konstatoi se Qeveria kishte shkaktuar dëm ndaj të dy aksionarëve të shoqërisë me pronësi të përzier, kështu që edhe nëse supozohej që qeveria nuk ishte përgjegjëse sipas kontratës, ajo ishte përgjegjëse në formë jokontraktuale.

26. Tribunalin konstatoi gjithashtu se shoqëria kërkuese kishte filluar përgatitjen e dokumenteve teknike paraprake përkatëse për ndërtimin e një hoteli, ndërtimi i të cilit nuk mund të vijonte si rezultat i pengesave të krijuara nga autoritetet shqiptare, siç dëshmohej nga një sërë korrespondencash të autoriteteve shtetërore me shoqërinë kërkuese.

27. Në përgjigje të pretendimit të Qeverisë se nuk mund të ishte pjesë e një marrëveshjeje me subjektet private, tribunalin konstatoi se kontratat private ndërmjet qeverive sovraane dhe investitorëve ishin të zakonshme në të drejtën ndërkombëtare të biznesit dhe nuk shkelnin parimin e sovranitetit.



28. Tribunali vuri në dukje se Marrëveshja 1991 kishte përjashtuar zbatueshmërinë e ligjit shqiptar, prandaj mungesa e pretenduar e legjitimitetit pasiv të Qeverisë, e cila bazohej në ligjin shqiptar, nuk mund të pranohej.

29. Tribunali kuptoi se në vendet komuniste si Shqipëria në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes 1991, ekonomia ishte e centralizuar dhe qeverisja qendrore ishte përgjegjëse për të gjitha nënndarjet e saj. Gjithashtu, shumë nga detyrimet e parashikuara në Marrëveshjen 1991 i ishin atribuar shprehimisht Qeverisë dhe ishin të një natyre të tillë që mund të përmbusheshin vetëm nga qeverisja qendrore.

30. Sipas tribunalit, me vendimin e saj të 28 marsit 1991 (shihni paragrafin 10 më lart) Marrëveshja 1991 jo vetëm që ishte “miratuar” nga qeveria, por edhe kishte hyrë në fuqi.

31. Gjithashtu, tribunali theksoi se Qeveria kishte marrë pjesë në zbatimin e Marrëveshjes 1991 duke caktuar anëtarë të bordit të drejtorëve të DIF, gjë që sugjeroi se Qeveria kishte nxjerrë të drejta dhe detyrime nga marrëveshja. Legjitimiteti pasiv i Qeverisë u mbështet njësoj nga natyra e deklaratave të bëra nga zëvendësministri për punët publike para tribunalit (shihni paragrafin 15 më lart). Tribunali doli në përfundim se nëse çështja u shqyrtua për përgjegjësinë kontraktuale ose jokontraktuale, Qeveria ishte përgjegjëse për dëmin që i kishte shkaktuar shoqërisë kërkuese.

32. Për sa i përket *quantum*, tribunali ra dakord me pretendimet e shoqërisë kërkuese të mbështetura nga një raport ekspertize që nuk ishte kundërshtuar nga Qeveria. Në këto kushte, tribunali vendosi me shumicën e votave në favor të shoqërisë kërkuese.

B. Njohja fillestare dhe procedura e ekzekutimit në Shqipëri

1. Proceset e njohjes

33. Më 25 maj 1995, Ministria e Financave informoi shoqërinë kërkuese se ajo do të paguante borxhin e saj pasi të merrte kredi nga bankat e huaja.

34. Më 11 mars 1998, shoqëria kërkuese paraqiti një kërkesë pa palë kundërshtare (d.m.th. pa përmendur palën kundërshtare) që Gjykata e Apelit Tiranë të njihte vendimin e arbitrazhit në rendin juridik shqiptar sipas neneve 393 et. seq. të Kodit të Procedurës Civile (“KPC”) (shihni paragrafin 67 më poshtë).

35. Më 2 prill 1998, Gjykata e Apelit Tiranë miratoi kërkesën dhe njohu vendimin e arbitrazhit duke e bërë atë të ekzekutueshëm. Meqë ky vendim

i referohej vetëm shumës së principalit, më 5 maj 2000 po kjo gjykatë e plotësoi vendimin e saj të parë duke njohur detyrimin e debitorit për të paguar edhe interesat (“vendimet e njohjes”).

2. Procedura e ekzekutimit

36. Më 10 prill 1998, Gjykata e Apelit Tiranë nxori një urdhër ekzekutimi në lidhje me vendimin e arbitrazhit të njohur nga vendimet e brendshme.

37. Më 11 nëntor 1998 dhe 20 maj 2002, një përmbarues i dërgoi Këshillit të Ministrave informacionin për borxhin ndaj shoqërisë kërkuese dhe rekomandoi që palët të hynin në negociata për kushtet e pagesës.

C. Kërkesë për rivendosje në afat

38. Në një datë të pa specifikuar, Këshilli i Ministrave depozitoi në Gjykatën e Apelit Tiranë një kërkesë për *rivendosje në afat* kundër vendimeve të njohjes. Më 26 dhjetor 2003, Gjykata e Apelit Tiranë pranoi kërkesën me arsyetimin se vendimet e kundërshtuara nuk i ishin njoftuar Këshillit të Ministrave.

D. Proceset vijuese në Shqipëri

1. Kthimet

39. Pas miratimit të kërkesës së tyre për rivendosje në afat, më 5 janar 2004, Këshilli i Ministrave depozitoi një ankim për çështjet e ligjit duke kundërshtuar vendimet e njohjes.

40. Më 10 shkurt 2005, Gjykata e Lartë i prishi ato vendime dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim. Ajo u shpreh se Këshillit të Ministrave duhej t'i jepej mundësia për të kundërshtuar njohjen e vendimit të arbitrazhit.

41. Më 14 shkurt 2006, Gjykata e Apelit Tiranë vendosi pushimin e shqyrtimit të çështjes. Ajo u shpreh se përfaqësuesi i shoqërisë kërkuese nuk kishte marrë një autorizim të vlefshëm nga drejtuesi i saj për të filluar proceset e njohjes në Shqipëri. Shoqëria kërkuese bëri ankim për çështjet e ligjit.

42. Më 26 shtator 2007, Gjykata e Lartë e prishi vendimin e gjykatës më të ulët dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim. Ajo u shpreh se gjykata e apelit nuk e kishte dëgjuar shoqërinë kërkuese për çështjen e autorizimit dhe nuk i kishte dhënë asaj mundësinë të korrigjonte gabimet e pretenduara në këtë drejtim.

2. Rrëzimi i kërkesës për njohje

43. Gjatë rigjykimit, shoqëria kërkuese parashtroi se Qeveria nuk mund të ngrinte para Gjykatës pretendimet që ajo nuk i kishte ngritur përpara tribunalit të arbitrazhit. Në veçanti, ajo vuri në dukje se Qeveria nuk e kishte kundërshtuar zgjidhjen e



mosmarrëveshjes me arbitrazh dhe as ligjshmërinë e Marrëveshjes 1991 përpara tribunalit të arbitrazhit.

44. Më 31 mars 2009, Gjykata e Apelit Tiranë rrëzoi kërkesën e shoqërisë kërkuese për njohjen e vendimit të arbitrazhit. Ajo gjeti disa shkelje të “parimeve bazë të ligjit shqiptar” në kuptimin e nenit 394 (dh) të Kodit të Procedurës Civile (shihni paragrafin 67 më poshtë) dhe të nenit V (2) të Konventës së 1958 për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit (“Konventa e Nju-Jorkut”) (shihni paragrafin 68 më poshtë). Në lidhje me Konventën e Nju-Jorkut, gjykata sqaroi se megjithëse ishte bërë e detyrueshme në Shqipëri në janar 2000, ajo u klasifikua si “e drejtë procedurale” dhe për këtë arsye ishte e zbatueshme për mosmarrëveshjen në shqyrtim.

45. Gjykata gjeti, së pari, se Marrëveshja 1991 krijonte të drejta dhe detyrime vetëm për shoqërinë komunale nënshkruese të marrëveshjes, jo për Qeverinë. Qeveria thjesht kishte autorizuar Marrëveshjen 1991 pa marrë përsipër detyrime ndaj shoqërisë kërkuese dhe sipas ligjit shqiptar organet shtetërore mbanin përgjegjësi individuale dhe jokolektive.

46. Së dyti, shoqëria kërkuese nuk ishte regjistruar rregullisht në Shqipëri. Themelimi i saj në Itali ishte bërë më 17 prill 1991, disa javë pas datës 26 mars 1991 kur nënshkroi marrëveshjen me autoritetet shqiptare.

47. Së treti, ligji i shoqërive me kapital të huaj parashikonte që marrëveshjet për themelimin e këtyre shoqërive rregulloheshin nga ligji shqiptar (shihni paragrafin 5 më lart), prandaj nuk ishte e hapur për palët në Marrëveshjen 1991 që të zgjidhnin një ligj të huaj si ligj rregullues (shihni paragrafin 8 më lart).

48. Së katërti, asnjë nga palët nuk mund të shmangte gjykatat shqiptare dhe të zgjidhte arbitrazhin për të zgjidhur mosmarrëveshjen e tyre pasi kjo mundësi ishte e ndaluar si nga neni 70 i Kodit të Procedurës Civile të vitit 1981 (“KPC”, shihni paragrafin 64 më poshtë) ashtu edhe nga neni 37 i KPC-së 1996 në fuqi (shihni paragrafin 66 më poshtë). Arbitrazhi ishte i mundur, sipas nenit 31 të ligjit për të drejtat civile të të huajve, vetëm kur parashikohej nga një traktat ndërkombëtar ku Shqipëria bënte palë (shihni paragrafin 63 më poshtë).

49. Në lidhje me këtë, një marrëveshje ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë e datës 12 shtator 1991 “për

nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve” parashikonte që investitorët mund të fillonin procedurat e arbitrazhit për të mbrojtur të drejtat e tyre në lidhje me investimet e tyre. Megjithatë, gjykata konstatoi se kjo marrëveshje nuk ishte “një marrëveshje ndërkombëtare e miratuar me ligj” në kuptimin e legjislacionit në fuqi. Sidoqoftë, kjo marrëveshje ishte miratuar disa muaj pas nënshkrimit të Marrëveshjes 1991 dhe megjithëse ishte në fuqi kur u zhvilluan proceset e arbitrazhit, ajo nuk mund të shërbente në mënyrë retroaktive si bazë për klauzolën e arbitrazhit.

50. Gjithashtu, ligji i vitit 1990 për mbrojtjen e investimeve të huaja nuk ishte një marrëveshje ndërqeveritare apo një konventë ndërkombëtare sipas kuptimit të nenit 31 të ligjit për të drejtat civile të të huajve të vitit 1964, prandaj ai nuk mund të shërbente si bazë për arbitrazhin.

51. Së pesti, arbitrat nuk e kishin dërguar draftin e vendimit të arbitrazhit për miratim te sekretariati i ICC-së siç kërkohet nga rregullat e ICC-së të zbatueshme në atë kohë dhe sekretariati i ICC-së nuk i kishte njoftuar vendimin Qeverisë.

52. Së gjashti, përkthimet e Marrëveshjes 1991 dhe vendimit të Arbitrazhit nuk ishin në përputhje me kërkesat e përkthimit të miratuara në vitin 2004 dhe 2005. Shoqëria kërkuese nuk kishte dhënë kopjen origjinale ose të njësuar të vendimit të Arbitrazhit.

3. Proceset gjyqësore përpara gjykatave të larta

53. Më 26 prill 2009, shoqëria kërkuese paraqiti ankim në Gjykatën e Lartë për të kundërshtuar të gjitha gjetjet e gjykatës së apelit. Ajo parashtroi në veçanti se vendimi i arbitrazhit nuk ishte në kundërshtim me ligjin shqiptar dhe se, gjithsesi, shkelja e një ligji nuk ishte e mjaftueshme për shkeljen e nenit 394 (dh) të KPC-së, i cili kërkonte shkeljen e “parimit bazë të ligji shqiptar” për të mohuar njohjen e një vendimi (shihni paragrafin 67 më poshtë). Në lidhje me Konventën e Nju-Jorkut, ku Shqipëria ka aderuar në janar 2000, shoqëria kërkuese pretendoi se ajo nuk ishte e zbatueshme sepse kishte hyrë në fuqi në lidhje me Shqipërinë pas fakteve përkatëse. Pavarësisht kësaj, konventa në fjalë nuk justifikonte rrëzimin e kërkesës për njohje.

54. Për më tepër, ajo parashtroi se palët ishin të lira të zgjidhnin ligjin rregullues të marrëveshjes dhe të zgjidhnin mosmarrëveshjet me arbitrazh. Në këtë drejtim, ajo theksoi se neni 8 i ligjit për mbrojtjen e



investimeve të huaja ishte i mjaftueshëm për të ofruar një bazë për arbitrazhin.

55. Më 12 prill 2012, Gjykata e Lartë hodhi poshtë ankimin e shoqërisë kërkuese për çështjet e ligjit me anë të një vendimi *de plano* duke vënë në dukje se ai nuk përfshinte asnjë argument të pranueshëm në shkallë të lartë.

56. Në një datë të papërcaktuar, shoqëria kërkuese paraqiti një ankim kushtetues.

57. Më 10 korrik 2013, Gjykata Kushtetuese prishi vendimin e Gjykatës së Lartë, duke vënë në dukje se ajo gjykatë në vendimin e saj duhej të kishte renditur arsyet e ankimit të shoqërisë kërkuese për të treguar se ato ishin shqyrtuar siç duhej.

58. Për sa i përket ankimit që vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, i datës 26 dhjetor 2003, për të lejuar rivendosjen në afat të Qeverisë shkelte parimin e sigurisë juridike, Gjykata Kushtetuese konstatoi se ankimi nuk ishte ngritur në Gjykatën e Lartë dhe sidoqoftë nuk i është sjellë brenda afatit ligjor prej dy vjetësh. Prandaj, ajo e refuzoi atë si të vonuar.

59. Më 4 tetor 2013, Gjykata e Lartë vendosi edhe një herë kundër shoqërisë kërkuese. Vendimi i saj parashtronte arsyet e ankimit të shoqërisë kërkuese dhe i hodhi poshtë ato me një arsyetim *de plano*.

60. Më 2 dhjetor 2014, shoqëria kërkuese paraqiti një tjetër ankim kushtetues.

61. Më 22 dhjetor 2015, Gjykata Kushtetuese rrëzoi ankimin duke konstatuar se vendimi i Gjykatës së Lartë ishte i arsyetuar siç duhej dhe se nuk kishte gjetje të shkeljes së kërkesave për gjykim të drejtë.

E. Proceset e njohjes në ITALI

62. Më 16 korrik 2014, Gjykata e Apelit Romë njohu vendimin e arbitrazhit në Itali.

E DREJTA E BRENDSHME DHE NDËRKOMBËTARE

A. Ligji i vitit 1964 mbi gëzimin e të drejtave civile nga të huajt (ligji nr. 3920 i 21 nëntorit 1964 “Mbi gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj”, i cili ishte në fuqi deri në 1 korrik 2011).

63. Nenet përkatëse të ligjit për të drejtat civile të të huajve parashikonin:

“Neni 26

Moszbatimi i ligjit të huaj

Në asnjë rast nuk mund të zbatohen ose të kenë efekt në territorin e Republikës Popullore të Shqipërisë ligjet ose dispozitat e tjera të një shteti të huaj si dhe kushtet e vëna në kontratat e palëve, kur këto janë në kundërshtim me rendin shtetëror dhe shoqëror të Republikës Popullore të Shqipërisë.

[...]

Neni 31

Moszbatimi i dispozitave të kësaj ligje kur ka konventa ndërkombëtare

Dispozitat e kësaj ligje nuk zbatohen kur me konventa ndërkombëtare në të cilat ka marrë pjesë Republika Popullore e Shqipërisë janë caktuar dispozita të ndryshme [në lidhje me çështjet që mbulon ky ligj].”

B. Kodi i Procedurës Civile 1981 (ligji nr. 6341 i 27 qershorit 1981)

64. Neni 70 i Kodit të Procedurës Civile 1981 (ligji nr. 6341 i 27 qershorit 1981 që ishte në fuqi deri në 1 qershor 1996) lexon:

“Neni 70

Palët në një mosmarrëveshje gjyqësore nuk mund të bien dakord që mosmarrëveshjet brenda kompetencës së gjykatave shqiptare t’i paraqesin gjykatave ose arbitrave të huaj. Përfundim bëhet për kontratat e lidhura ndërmjet shoqërive tregtare jashtë vendit dhe të huajve, me kusht që marrëveshja të bëhet me shkrim dhe të miratohet nga ministria përkatëse.”

C. Ligji për mbrojtjen e investimeve të huaja (dekreti i Presidiumit të Kuvendit Popullor nr. 7406 “Për mbrojtjen e investimeve të huaja” në fuqi deri më 20 gusht 1992)

65. Pjesa 8 e ligjit lexon:

“Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë do të nxisë frymën e vullnetit të mirë dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e shpejtë dhe të drejtë të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet palëve investuese. Nëse kjo nuk arrihet, me kërkesë të secilës palë, çështja do t’i dërgohet arbitrazhit të zgjedhur prej tyre.”



D. Kodi i Procedurës Civile 1996 (i ndryshuar dhe aktualisht në fuqi)

66. Neni 37 i KPC-së lexon:

**“Neni 37
(Ndryshuar me ligjin nr. 8812 të datës
17.5.2001)**

Juridiksioni i gjykatave shqiptare për personat fizikë dhe juridikë të huaj rregullohet me ligj.

Juridiksioni i gjykatave shqiptare nuk mund t'i kalohet me marrëveshje një juridiksioni të huaj, përveç kur gjykimi ka lidhje me një detyrim ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji e një shtetasi shqiptar, ose personi juridik pa banim ose qëndrim në Shqipëri, si dhe kur këto përjashtime janë parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.”

67. Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja në Shqipëri rregullohet, mes të tjerave, në nenet e mëposhtme:

**“KREU IX
NJOHJA E VENDIMEVE TË HUAJA**

Neni 393

Kushtet për zbatimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e huaja

Vendimet e gjykatave të shteteve të huaja njihen dhe zbatohen në Republikën e Shqipërisë, në kushtet e parashikuara në këtë Kod ose në ligje të veçanta.

Kur për këtë qëllim ka marrëveshje të posaçme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit të huaj zbatohen dispozitat e marrëveshjes.

Neni 394

Pengesat ligjore për zbatimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e huaja

Vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur:

[...]

dh) nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

Neni 395
Shqyrtimi i kërkesës

Kërkesa për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj i paraqitet gjykatës së apelit.

[...]

Neni 397

Gjykata e apelit nuk e shqyrtton çështjen në themel, por vetëm kontrollon nëse vendimi i paraqitur nuk përmban dispozita që vijnë në kundërshtim me nenin 394 [të KPP-së].

[...]

Neni 398

Zbatimi i vendimit të një gjykate të huaj

Vendimi i gjykatës së shtetit të huaj zbatohet në Republikën e Shqipërisë vetëm në bazë të vendimit të gjykatës të apelit që i jep fuqi këtij vendimi [të huaj] dhe ekzekutohet në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij Kodi.

Neni 399

Vendimi i gjykatës së arbitrazhit

Dispozitat e këtij kreu zbatohen edhe për njohjen e vendimit përfundimtar të një arbitrazhi të shtetit të huaj.”

E. Konventa e 1958 për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit (“Konventa e Nju-Jorkut”)

68. Neni V i Konventës së Nju-Jorkut lexon si më poshtë:

Neni V

[...]

2. Njohja dhe ekzekutimi i një vendimi arbitrazhi gjithashtu mund të refuzohet nëse autoriteti kompetent në vendin ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi konstaton se:

a) Objekti i mosmarrëveshjes nuk mund të zgjidhet me arbitrazh sipas ligjit të atij vendi; ose

b) Njohja ose ekzekutimi i vendimit do të ishte në kundërshtim me politikën publike të atij vendi.”



VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Shkelja e pretenduar e paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës

1. *Shkelja e sigurisë juridike si rezultat i rivendosjes në afat të Qeverisë*

69. Shoqëria kërkuese u ankua se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, i datës 26 dhjetor 2003, i cili lejonte Qeverinë të paraqiste ankim jashtë afatit (shihni paragrafin 38 më lart) përbënte shkelje të parimit të sigurisë juridike.

70. Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar që lejonte Qeverinë të paraqiste një ankim jashtë afatit ishte një akt i menjëhershëm që nuk krijoi një situatë të vazhdueshme, edhe nëse kjo do të sillte rihapjen e proceseve (krahasoni me *Khanyan kundër Armenisë* (vendim), nr. 19065/05, 5 korrik 2007; dhe *Gargali kundër Bullgarisë* (vendim), nr. 67670/01, 5 qershor 2006). Për më tepër, nëse nuk ka mjet ligjor adekuat kundër një akti të caktuar që pretendohet se është në shkelje të Konventës, data e kryerjes së atij akti konsiderohet “përfundimtare” për qëllimet e rregullit gjashtëmujor (shihni, për shembull, *Stanca kundër Rumanisë* (vendim), nr. 59028/00, 27 prill 2004).

71. Shoqëria kërkuese parashtroi se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, i datës 26 dhjetor 2003, nuk iu njoftua, megjithatë Gjykata vlerëson se shoqëria kërkuese duhet të ketë marrë dijeni për atë vendim të paktën më 14 shkurt 2006, kur Gjykata e Apelit Tiranë vendosi edhe një herë për këtë çështje (shihni paragrafin 41 më lart). Shoqëria kërkuese nuk e paraqiti këtë ankim në Gjykatë brenda gjashtë muajve nga 14 shkurt 2006, datë në të cilën ajo duhet të kishte marrë dijeni për vendimin e kundërshtuar. Në fakt, në vitin 2013 Gjykata Kushtetuese e rrëzoi këtë ankim si të vonuar për të njëjtat arsye (shihni paragrafin 58 më lart).

72. Rrjedhimisht, ky ankim është i papranueshëm sipas paragrafit 1 të nenit 35 të Konventës për mosrespektim të rregullit të gjashtë muajve dhe për këtë arsye ai duhet të refuzohet në përputhje me paragrafin 4 të nenit 35 të saj.

2. *Mosekzekutimi i vendimit të arbitrazhit*

73. Shoqëria kërkuese u ankua se mosekzekutimi i vendimit të arbitrazhit nga Qeveria ishte gjithashtu në kundërshtim me të drejtën e saj për t’ju drejtuar gjykatës sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës.

74. Gjykata përsërit që ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga një gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë e pandarë e “seancës gjyqësore” për qëllime të

nenit 6. Gjithashtu ajo i referohet praktikës gjyqësore në lidhje me mos-ekzekutimin ose ekzekutimin me vonesë të vendimeve të brendshme të formës së prerë (shihni *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, 40, raporte të vendimeve 1997 II).

75. Gjykata vëren se sipas ligjit të brendshëm, procedurat për njohjen e një vendimi të huaj arbitrazhi i paraprinë dhe ish-in të dallueshme nga procedurat e mëvonshme në lidhje me ekzekutimin e tij (shihni paragrafët 35–36 dhe 67 më lart).

76. Rrjedhimisht, shoqëria kërkuese ishte e detyruar të siguronte njohjen e brendshme të vendimit të Arbitrazhit (krahasoni me *Marini kundër Shqipërisë*, nr. 3738/02, §§ 73–75, 18 dhjetor 2007, ku vendimi i brendshëm i arbitrazhit, pasi bëhet përfundimtar, ishte i detyrueshëm në lidhje me Shtetin). Ky përfundim nuk ndryshon nga fakti, sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës, që shoqërisë kërkuese nuk i kërkohet të fillonte procedurat e ekzekutimit kundër Shtetit (shihni *Metaxas kundër Greqisë*, nr. 8415/02, § 19, 27 maj 2004).

77. Megjithëse vendimi i arbitrazhit fillimisht u njoh nga gjykatat e brendshme, kjo njohje u anulua më pas dhe përfundimisht u refuzua (shihni paragrafët 35, 40 dhe 43).

78. Fakti që vendimi u njoh në Itali nuk e ndryshon faktin që ai nuk u njoh në Shqipëri. Në këto rrethana, për sa i përket sistemit ligjor shqiptar, shoqëria kërkuese nuk kishte një vendim detyrues në favor të saj.

79. Nga kjo rrjedh se ankimi për mosekzekutimin e vendimit të panjohur të arbitrazhit është haptazi i pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me paragrafët 3 (a) dhe 4 të nenit 35 të Konventës.

B. Shkelja e pretenduar e nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës për shkak të mosekzekutimit të vendimit të arbitrazhit

80. Shoqëria kërkuese u ankua se mosekzekutimi i vendimit të arbitrazhit nga Qeveria ishte në kundërshtim me të drejtën e saj të pronës sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

1. *Nëse ka pasur “pasuri” sipas kuptimit të nenit 1*

81. Gjykata ka vlerësuar në një sërë çështjesh që pretendimet e bazuara në vendimet e arbitrazhit, sa i përket statusit të tyre specifik sipas ligjit të brendshëm, përbënin “pasuri” sipas kuptimit të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës (*Rafineritë Greke Stran dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë*, 9 dhjetor 1994, §§ 67–68, seria A nr. 301-B, dhe *BTS*



Holding, a.s. kundër Sllovakisë nr. 55617/17, §§ 49–51, 30 qershor 2022). Në rastin konkret, pretendimi i shoqërisë kërkuese bazohej në vendimin e Arbitrazhit, i cili ishte përfundimtar dhe mund të kundërshtohet vetëm për arsyet e kufizuara të parashikuara në nenet 394 dhe 397 të KPC-së (shihni paragrafin 67 më lart). Kështu, megjithëse vendimi nuk u njoh përfundimisht nga gjykatat vendase, mund të thuhet se përbënte një “pritshmëri legjitime” në kushtet e nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës (shihni *Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, 20 nëntor 1995, § 31, seria A nr. 332).

2. Nëse ka pasur ndërhyrje

82. Shoqëria kërkuese parashtroi se mosekzekutimi i vendimit të Arbitrazhit ndërhynte në të drejtat e saj të pronës. Gjykata ka vënë në dukje tashmë se procedurat për njohjen e një vendimi të huaj arbitrazhi i paraprinë dhe ishin të ndryshme nga procedurat e mëvonshme në lidhje me ekzekutimin e tij (shihni paragrafin 75 më lart).

83. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se ishte mosnjohja e vendimit të Arbitrazhit që ndërhyri në të drejtat e pronës së shoqërisë kërkuese, dhe jomosekzekutimi i tij që ishte përfundimisht pasojë e mosnjohjes.

84. Kjo ndërhyrje nuk përbënte as privim të pronës sipas kuptimit të fjalisë së dytë të nenit 1 të protokollit nr. 1, as masë kontrolli të përdorimit të pronës sipas kuptimit të fjalisë së tretë të tij.

Prandaj, ai duhet të shqyrtohet sipas rregullit të përgjithshëm të parashikuar në fjalinë e tij të parë (*shihni Rafineritë Greke Stran dhe Stratis Andreadis*, cituar më lart, §§ 67 dhe 68).

3. Pajtueshmëria e ndërhyrjes me nenin 1 të protokollit nr. 1 të Konventës

85. Ekziston një kusht thelbësor që ndërhyrja të konsiderohet në pajtim me nenin 1 të protokollit nr.1 që të jetë e ligjshme, ku kompetenca e Gjykatës për të shqyrtuar pajtueshmërinë me të drejtën e brendshme kufizohet me rastet e zbatimit dukshëm të gabuar të dispozitave ligjore të kundërshtuara ose ku nxirren konkluzione arbitrare (shihni, për shembull, *Beyeler kundër Italisë* [DHM], nr. 33202/96, § 108, GJEDNJ 2000-I, me referenca të mëtejshme).

86. Në shqyrtimin e ligjshmërisë së ndërhyrjes në çështjen në fjalë, Gjykata duhet të konstatojë nëse ka pasur një gabim të dukshëm apo arbitraritet në gjetjet e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, të

datës 31 mars 2009 (shihni paragrafët 44–52), i cili më pas u la në fuqi nga gjykatat e larta.

87. Në lidhje me këtë, Gjykata duhet të vërë në dukje se në formularin e saj të kërkesës shoqëria kërkuese u ankua në terma të përgjithshëm për mos ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit, por nuk bëri parashtrime të detajuara në lidhje me arsyet e ndryshme të mosnjohjes që përmbante vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, i datës 31 mars 2009.

88. Në parashtrimet e saj të mëvonshme përpara Gjykatës, shoqëria kërkuese komentoi dy çështje që mund të shihen si kundërshtim i gjetjeve të Gjykatës së Apelit.

89. Së pari, ajo shpjegoi se sipas ligjit italian, veprimet e një drejtori ose përfaqësuesi të një shoqërie në themelim mund të ratifikohen më pas nga shoqëria e re pasi të jetë regjistruar rregullisht (shihni paragrafin 46 më lart). Më pas këto veprime u konsideruan si të kryera nga shoqëria e regjistruar rishtazi.

90. Së dyti, shoqëria kërkuese vuri në dukje se vendimi i arbitrazhit nuk ishte dhënë nga një tribunal i ICC-së, që kishte vepruar vetëm si autoritet caktues i një arbitri (shihni paragrafët 12 dhe 51 më lart).

91. Megjithatë, me përjashtim të argumenteve të mësipërme, parashtrimet e shoqërisë kërkuese para Gjykatës nuk përfshinin asnjë sfidë tjetër specifike për gjetjet e mbetura të Gjykatës së Apelit Tiranë, në veçanti konkluzionin e saj se njohja e vendimit do të kishte qenë në shkelje të “parimeve bazë të ligjit shqiptar”.

92. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson konstatimet e gjykatave të brendshme se në kohën e nënshkrimit të Marrëveshjes 1991 ndërmjet shoqërisë kërkuese dhe autoriteteve shqiptare, Shqipëria ishte ende republikë socialiste, sistemi ligjor i së cilës përfshinte kufizime dhe kushte të forta për njohjen e vendimeve të huaja, përfshirë edhe vendimet e huaja të arbitrazhit kundër shtetit shqiptar. Në thelb, kjo njohje ishte e mundur vetëm nëse bazohej në një traktat ndërkombëtar të ratifikuar nga Shqipëria që parashikonte në mënyrë specifike zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me shtetin shqiptar nëpërmjet arbitrazhit ndërkombëtar (shihni paragrafin 48 më lart). Mbështetur në ligjin për të drejtat civile të të huajve të vitit 1964, lexuar së bashku me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile të vitit 1981, i cili ishte në fuqi në kohën e nënshkrimit të Marrëveshjes 1991 – si dhe dispozitat e ngjashme të Kodit të Procedurës Civile



të vitit 1996, i cili ishte në fuqi në kohën e vendimit të brendshëm përkatës – dhe parimet e përgjithshme të Konventës së Nju-Jorkut, gjykatat e brendshme dolën në përfundimin se në kohën e nënshkrimit të Marrëveshjes 1991 nuk ekzistonte asnjë traktat i tillë ndërkombëtar. Për rrjedhojë, vendimet e arbitrazhit ishin në kundërshtim me “parimet bazë të ligjit shqiptar”.

93. Në këto rrethana, Gjykata nuk është në gjendje të dalë në përfundimin se vendimi i gjykatave të brendshme për mosnjohjen e vendimit të arbitrazhit në Shqipëri në përgjithësi ishte haptazi i paligjshëm ose arbitrar (shihni, *a contrario*, *BTS Holding a.s.*, cituar më lart, § 66-73).

94. Për më tepër, duke pasur parasysh praktikën gjyqësore të Gjykatës (shihni *Lekic kundër Sllovenisë* [DHM], nr. 36480/07, §§ 94-95 dhe 105, 11 dhjetor 2018), mos njohja dhe, për rrjedhojë, mosekzekutimi i vendimit të Arbitrazhit, i cili u gjet në papajtueshmëri me parimet bazë të ligjit shqiptar, nuk mund të cilësohet si joproporcional ose përndryshe i papajtueshëm me paragrafin e dytë të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

95. Për rrjedhojë, ankimi është haptazi i pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me paragrafët 3 (a) dhe 4 të nenit 35 të Konventës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA,
UNANIMISHT,

Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 16 maj 2024.

Olga Chernishova **Georgios A. Serghides**
Zëvendëskancelare President

URDHËR
Nr. 51, datë 29.5.2024

PËR SHFUQIZIMIN E
KOMPETENCAVE TË DELEGUARA

Në mbështetje të neneve 22, 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 285, datë

19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJMË:

1. Shfuqizimin e kompetencave të deleguara z. Florian Ballhysa, komisioner publik, me urdhrin nr. 28, datë 12.3.2024, “Për delegim kompetencash”.

Ky urdhër hyn në fuqi më datë 29.5.2024 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERË PUBLIKË
Florian Ballhysa
Irena Nino

URDHËR
Nr. 52, datë 29.5.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe urdhrin të Komisionerëve Publikë nr. 51, datë 29.5.2024, “Për shfuqizimin e kompetencave të deleguara”,

URDHËROJMË:

1. Kompetencat e titullarit të Autoritetit Kontraktor, për procedurat e prokurimit në Institucionin e Komisionerëve Publikë, të kryhen nga znj. Alketa Çeli, me detyrë kancelar i institucionit.

2. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.

Ky urdhër hyn në fuqi më datë 29.5.2024 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERË PUBLIKË
Florian Ballhysa
Irena Nino

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me vendimin nr. 973, datë 27.12.2023, vendosi heqjen e plotë të zotësisë juridike për të vepruar të shtetasit Mehmet Petritaj, i datëlindjes 17.7.1989, i biri i Lavdit dhe i Shqiponjës, si dhe caktimin si kujdestar dhe përfaqësues ligjor të tij, shtetasin Napolon Petritaj, i datëlindjes 15.9.1967, lindur në Malas, Breg, Berat.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 144 lekë